



Organizata për
Demokraci, Antikorrupsion
dhe Dinjitet, Çohu!



Kingdom of the Netherlands



QASJA NË DREJTËSI

Raport i monitorimit në
gjykatat themelore në
Republikën e Kosovës
tetor 2018 – shtator 2019

2019

QASJA NË DREJTËSI



Raport i monitorimit në
gjykatat themelore në
Republikën e Kosovës
tetor 2018 – shtator 2019

2019



Shënim:

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen e Ambasadës Holandeze në Kosovë. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e organizatës Çohu! dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të donatorit.



Kingdom of the Netherlands

Përpiluar nga:

Genc Nimoni dhe Rina Koliqi

Monitorues:

Drilon Dobruna, Artan Sufaj, Albana Krasniqi

Redaktor :

Qerim Ondozi

Origjinali është shkruar në shqip

Publikuar nga:

Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet,
Çohu!

Rruga: UÇK 25-1; Prishtinë, Kosovë

Tel / +383 (0)38 248 506

www.cohu.org

SHKURTESAT

GjTh

Gjykata Themelore

PTh

Prokuroria Themelore

KGJK

Këshilli Gjyqësor i Kosovës

PSRK

Prokuroria Speciale e Kosovës

KPK

Këshilli Prokurorial i Kosovës

AKP

Agjencia Kosovare e Privatizimit

KPRK

Kodi Penal i Kosovës

KVPP

Komisioni për Vlerësimin e Performancës
së Prokurorëve

KPPK

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës

ÇOHU!

Organizata për Demokraci,
Anti-korrupsion dhe Dinjitet

KPK

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës

KP

Kallëzime Penale

PËRMB

Lista e shkurtesave.....	5
Përmbledhja ekzekutive	8
Hyrje	10
1. Gjetjet e Monitorimit	11
1.1 Seancat gjyqësore – vonesat dhe shkeljet.....	11
1.2 Fillimi i seancave gjyqësore me vonesë	12
1.3 Shtyrja e seancave.....	15
1.4 Ndërprerja e seancave gjyqësore	18
1.5 Shkelja e afateve ligjore	19
1.5.1 Shkelja e afateve në shqyrtimin fillestar.....	20
1.5.2 Shkelja e afateve në shqyrtimin dytësor	20
1.5.3 Shkelja e afateve në shqyrtimin kryesor	21
1.5.4 Shkelja e afateve lidhur me përfundimin e shqyrtimin kryesor	21
1.6 Parashkrimi i lëndëve	22
1.7 Përfaqësimi i aktakuzave dhe papërgatitja e prokurorëve	23
1.8 Ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues	25
2. Rastet e profilit të lartë - Luftimi i korrupsionit të nivelit të lartë	27
2.1 Mungesa e të dhënave për profilet e larta.....	29

BAJ TJ

3. Performanca e prokurorëve dhe gjykatësve në procedimin dhe trajtimin e rasteve 30

- 3.1 Institucionet për vlerësimin e performancës..... 30
- 3.2 Metodologjia e vlerësimit të performancës së prokurorëve dhe gjykatësve.....31
- 3.3 Raste praktike të dështimit të prokurorëve dhe gjykatësve dhe mungesa e llogaridhënies 32

4. Drejtësia në Mitrovicë 33

- 4.1 Prokuroria dhe Gjykata në Mitrovicë 33
- 4.2 Struktura organizative e Prokurorisë dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë sipas Marrëveshjes së Brukselit..... 33
- 4.3 Ndërprerja e Punës së Gjykatës – nëntor 2018..... 34
- 4.4 Numri i prokurorëve dhe gjykatësve si dhe procedimi me lëndët 35
- 4.5 Ngarkesa me lëndët dhe efikasiteti..... 36
- 4.6 Mungesa e përkthyesve..... 38
- 4.7 Parashkrimi në Mitrovicë 39

PËRFUNDIME 41

REKOMANDIME 42

ANEKS 43

5. Efikasiteti i prokurorive dhe gjykatave në trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar 43

- 5.1 Rastet e korrupsionit ndër vite 43
- 5.2 Rastet e krimit të organizuar ndër vite..... 45
- 5.3 Rastet e seancave që kanë filluar me vonesë..... 46
- 5.4 Rastet e shtyrjes së seancave gjyqësore 50
- 5.5 Rastet e ndërprerjes së seancave gjyqësore..... 54

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet, Çohu! (tutje në tekst organizata Çohu!), ka vazhduar marrëveshjen e bashkëpunimit me Këshillin Gjyqësor të Kosovës (tutje në tekst KGJK) për monitorimin e gjykatave. Pas nënshkrimit të marrëveshjes në muajin tetor 2018, organizata ka filluar monitorimin me ç'rast në fokus ishin rastet e korrupsionit si dhe rastet e krimit të organizuar.

Gjatë periudhës njëvjeçare, monitorimi i Organizatës Çohu! është bërë në baza ditore me ç'rast janë monitoruar gjithsej **242 raste** me **575 seanca gjyqësore** në gjykatat themelore në **Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Ferizaj, Prizren, Gjiilan dhe Gjakovë**. Monitorimi ka identifikuar gjetje të ndryshme, duke filluar nga ato më teknike siç është vonesa në fillimin e shqyrtimeve gjyqësore, e deri të shkeljet e afateve procedurale ligjore dhe shkeljet e të drejtave të njeriut.

Edhe pse të trajtuara me prioritet nga gjykatat, rastet e korrupsionit vazhdojnë të barten nga viti në vit.

Organizata Çohu! në kuadër të monitorimit ka realizuar edhe tri hulumtime në fushën e drejtësisë:

Drejtësia në Mitrovicë – regjioni që përfshin komunitetet e veriut të Republikës së Kosovës është shoqëruar me tranzicione të vazhdueshme të cilat kanë pasur pasoja në performancën e prokurorisë dhe gjykatave, ku për më shumë se 8 vjet nuk ka funksionuar gjyqësori. Në shkurt të vitit 2015 në bisedimet Kosovë–Serbi në Bruksel është arritur Marrëveshja për Drejtësinë e cila filloi të zbatohet në fund të vitit 2017, qëllimi i së cilës ishte integrimi i pjesës veriore në sistemin e drejtësisë së Kosovës.

Korrupsioni i nivelit të lartë – duke u bazuar në të dhënat e monitorimit në shtatë gjykatat themelore janë identifikuar vetëm 17 raste të korrupsionit të nivelit të lartë në të cilat janë përfshirë deputetë, ministra dhe kryetarë të komunave.

Performanca e Gjykatësve – për vlerësimin e performancës së prokurorëve dhe gjyqtarëve janë krijuar njësitet të posaçme, deri më tani organet kompetente për vlerësim të performancës së prokurorëve dhe gjykatësve nuk kanë marrë ndonjë masë ndëshkuese ndaj prokurorëve dhe gjykatësve të cilët kanë treguar mungesë profesionalizmi në trajtimin e lëndëve, me theks të veçantë në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Duke u bazuar në të dhënat e monitorimit nga gjithsej 242 rastet e monitoruara, 17 janë të kualifikuara si korrupsion i nivelit të lartë. Sipas të dhënave të monitorimit, në rastet e korrupsionit të lartë janë përfshirë personat nga profilet e ndryshme si: deputetë, ministra, zv/ministra, kryetarë të komunave, kryetarë të gjykatave, kryeprokurorë e të tjerë. Gjatë monitorimit njëvjeçar Çohu! ka identifikuar raste të mungesës së përgatitjes së prokurorëve dhe gjykatësve në seanca gjyqësore, parashkrim të lëndëve të korrupsionit, shkelje të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me afatet ligjore të procedimit të rasteve si dhe mungesë të respektimit të dispozitave ligjore lidhur me ndërprerjen e seancave gjyqësore.

Organizata Çohu! ka analizuar dhe ka krahasuar të dhënat e KGJK-së dhe KPK-së ndër vite. Nga këto të dhëna vërehet se përkundër prioritetit që do duhej të kishin lëndët e korrupsionit dhe krimit të organizuar ato megjithatë vazhdojnë të barten nga viti në vit.

Rekomandimet adresojnë gjetjet për institucionet kryesore si KGJK, KPK, për gjykatat dhe prokuroritë dhe institucionet e tjera, me qëllim të përmirësimit të efektivitetit të masave për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit – e këto bien në kategorinë e kriminalitetit të shkallës së lartë. Këto rekomandime po ashtu janë të orientuara drejt respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut si dhe drejt parandalimit të shkeljes së legjislacionit në fuqi.



Organizata Çohu!
ka analizuar dhe ka krahasuar të dhënat e KGJK-së dhe KPK-së ndër vite. Nga këto të dhëna vërehet se përkundër prioritetit që do duhej të kishin lëndët e korrupsionit dhe krimit të organizuar ato megjithatë vazhdojnë të barten nga viti në vit.



HYRJE

Dukuria e korrupsionit dhe krimi të organizuar në Republikën e Kosovës vazhdon të mbetet mjaft shqetësuese. Përkundër faktit që shteti është i detyruar të ushtrrojë mbrojtje nga kjo formë e kriminalitetit, korrupsioni dhe krimi i organizuar vazhdojnë të jenë sfida kryesore për sistemin e drejtësisë.

Gjatë monitorimit të **242 rasteve me 575 seanca gjyqësore** për periudhën tetor 2018 – shtator 2019, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Ferizaj, Prizren Gjilan dhe Gjakovë, Organizata Çohu! ka identifikuar probleme si vonesat e fillimit të shqyrtimit gjyqësor dhe shtyrja e tyre, ndërprerjet e seancave gjyqësore, numri i madh i lëndëve, papërgatitja e prokurorëve për seanca gjyqësore, shkelja e dispozitave ligjore të cilat kanë të bëjnë me afatet ligjore të procedimit të rasteve si dhe shkelja e të drejtave të njeriut.

Krahas monitorimit të rasteve në gjykatat e lartcekura, Organizata Çohu! ka realizuar hulumtime rreth funksionimit të gjyqësorit në regjionin e Mitrovicës i cili përfshin komunat e veriut të Kosovës. Regjioni i Mitrovicës ka kaluar nëpër tranzicione të vazhdueshme, të cilat pashmangshëm kanë pasur pasoja në performancën e prokurorisë dhe të gjykatave.

Për shkak të po këtyre ngjarjeve dhe shumë rrethanave të tjera, sistemi gjyqësor dhe ai prokurorial në regjionin e Mitrovicës është përballur me probleme të vazhdueshme.

Marrëveshja për Drejtësinë e arritur në Bruksel më 9 shkurt 2015 në bisedimet Kosovë–Serbi, që kishte

për qëllim integrimin e pjesës veriore në sistemin e drejtësisë së Kosovës, nuk kishte arritur të zbatohet deri në fund të vitit 2017.

Përveç hulumtimit të funksionimit të gjyqësorit në regjionin e Mitrovicës, janë bërë edhe dy hulumtime të tjera në fushën e drejtësisë: hulumtimi i cili ka të bëjë me rastet e korrupsionit të nivelit të lartë si dhe ai i performancës së gjykatësve. Gjatë monitorimit të gjykatave janë identifikuar **17 raste të korrupsionit të cilat i përkasin profilin të lartë**.

Qytetarët vazhdojnë të ballafaqohen me problemin e zvarritjes së procedurave gjyqësore dhe me drejtësi jo-efikase. Megjithatë, deri më tani nuk ka pasur asnjë rast kur organi kompetent për vlerësimin e performancës së gjykatësve dhe prokurorëve të ketë marrë ndonjë masë për shkak të mungesës së profesionalizmit të gjykatësve apo prokurorëve.

Analiza dhe krahasimi i procedimit të të dhënave nga kapitujt e tillë të cilët kanë qenë në fokus të monitorimit është bërë gjithashtu për të gjitha lëndët në gjykatat themelore dhe prokuroritë themelore për periudhën 2015–2018. Analizimi dhe krahasimi i të dhënave është bërë duke u bazuar në të dhënat e siguruar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Duke u bazuar në gjetjet e monitorimit dhe analizën e të dhënave janë dhënë rekomandime duke vënë në pah gjetjet kryesore dhe adresimin e tyre për institucionet relevante të zbatimit të ligjit.

1. GJETJET E MONITORIMIT

Pas vazhdimit të bashkëpunimit përmes Marrëveshjes për Bashkëpunim të nënshkruar në tetor të vitit 2018 mes Organizatës Çohu! dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Organizata Çohu! ka nisur monitorimin e gjykatave themelore në Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj, Prizren, Pejë, Gjakovë dhe Gjiilan. Monitorimi është bërë në baza ditore, ku në fokus kanë qenë rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Duke u bazuar në të dhënat e monitorimit, për periudhën tetor 2018 – shtator 2019, Çohu! ka monitoruar gjithsej **575 seanca gjyqësore në 242 raste**. Gjatë monitorimit njëvjeçar janë identifikuar gjetjet e natyrave të ndryshme, duke filluar nga ato më teknike siç janë vonesat në fillimin e shqyrtimeve gjyqësore, e deri të shkeljet procedurale ligjore dhe shkeljet e të drejtave të njeriut.

Nga gjithsej 575 seancat e monitoruara me 242 raste, 97 seanca kanë filluar me vonesë, ndërsa janë shtyrë 114 seanca gjyqësore. Arsytet e shpeshta të kësaj shtyrje kishin qenë mungesa e trupit gjykues, prokurorit, të akuzuarve, dëshmitarëve e të tjera, ndërsa në pothuajse të gjitha rastet nuk janë respektuar afatet që kanë të bëjnë me caktimin e shqyrtimeve gjyqësore (fillestare, dytësore, kryesore) si dhe përfundimit të tyre.

Fillimi me vonesë, ndërprerja e seancave gjyqësore dhe shtyrja e seancave gjyqësore janë gjetje të tjera të monitorimit të cilat vazhdojnë të jenë evidente në të gjitha gjykatat themelore të Kosovës. Kjo dukuri po vazhdon të shkaktojë zvarritje në procesin gjyqësor dhe njëkohësisht shkelje të të drejtave të njeriut.

Gjatë monitorimit të seancave gjyqësore Organizata Çohu!, për periudhën tetor 2018 – shtator 2019 ka identifikuar 9 raste të parashkrimit të lëndëve të korrupsionit nga Kapitulli XXXIV i KPRK-së¹. Sipas të dhënave të KGJK-së dhe hulumtimit të Organizatës Çohu!, vetëm gjatë viteve 2013–2018 në gjykatat e Republikës së Kosovës janë parashkruar 58 lëndë të korrupsionit, prej të cilave 8 në aspektin relativ ndërsa 50 në aspektin absolut.

Gjatë monitorimit njëvjeçar Çohu! ka realizuar tri hulumtime, Drejtësinë në Mitrovicë, Korrupsionin e Nivelit të Lartë dhe Performancën e Gjykatësve dhe Prokurorëve. Që nga tetori i vitit 2017 në regjionin e Mitrovicës gjykata dhe prokuroria funksionojnë sipas Marrëveshjes për Drejtësinë, e arritur në Bruksel në vitin 2015 pas bisedimeve Kosovë – Serbi. Korrupsioni i Nivelit të Lartë ka qenë poashtu temë trajtimi nga Çohu! ku gjatë periudhës njëvjeçare janë identifikuar 17 raste të korrupsionit të lartë. Sa i përket Performancës së Gjykatësve dhe Prokurorëve, deri tani organet përkatëse të krijuara për vlerësimin e performancës së gjykatave dhe prokurorëve nuk kanë ndërmarrë asnjë masë ndëshkuese ndaj ndonjë prokurori apo gjykatësi për shkak të mungesës së profesionalizmit në zgjidhjen e rasteve.

1.1 Seancat gjyqësore – vonesat dhe shkeljet

Vijimi i një seance gjyqësore nëpër fazat e procedurës penale përveç problemeve dhe vështirësive të tjera është përcjellë edhe me vonesa të ndryshme procedurale.

¹ Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare

Monitorimi i Organizatës Çohu! ka identifikuar raste të ndryshme të vonesave procedurale, duke filluar nga ato që kanë të bëjnë me fillimin dhe zhvillimin e një seance gjyqësore, e deri te shkelja e afateve procedurale në fazat e zhvillimit të një seance gjyqësore.

Vonesa dhe shtyrje të seancave gjyqësore, varësisht nga faza e një seance (fillestare, dytësore, kryesore) apo edhe përfundimi i një seance kryesore, janë identifikuar në të gjitha gjykatat themelore në Republikën e Kosovës. Duke u bazuar në po këto gjetje të Organizatës Çohu! shkeljet e afateve figurojnë deri në 1,390 ditë², e të cilat njëkohësisht janë shkelje të dispozitave procedurale.

Sipas gjetjeve të Organizatës Çohu! arsyet e fillimit me vonesë të seancave gjyqësore dhe shtyrja e tyre vjen për shkak të vonesave dhe mungesave të vazhdueshme të trupit gjykues/gjykatësit të çështjes, prokurorit, mbrojtësit, të akuzuarit dhe të dëmtuarit. Vonesa dhe shtyrja e seancave ka ardhur edhe për shkaqe të tjera, siç janë mungesa e plotësimit të kushteve për seancë për shkak të mungesës së shkresave dhe provave të lëndës për të akuzuarit dhe mbrojtësit.

1.2 Fillimi i seancave gjyqësore me vonesë

Duke u bazuar në gjetjet e organizatës Çohu! nga gjithsej **575** seancat e monitoruara për periudhën tetor 2018 – shtator 2019, **97** prej tyre kanë filluar me vonesë. Vonesa e trupit gjykues dhe e prokurorëve janë ndër arsyet me të shpeshta të vonesave të fillimit të seancave.

Duke u bazuar po në gjetjet e Organizatës ÇOHU! nga gjithsej **97** seancat e filluara me vonesë, në **43** seanca arsye e fillimit me vonesë ishte vonesa e trupit gjykues.³ Sipas gjetjeve të identifikuara nga Organizata Çohu!, për shkak të vonesave të trupit gjykues, seancat nuk kishin filluar me kohë në gjykatat themelore në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren dhe Ferizaj.⁴

Vonesa e prokurorit gjithashtu është ndër arsyet e shpeshta të fillimit me vonesë. Sipas gjetjeve të Organizatës Çohu! **25** seanca kishin filluar me vonesë për shkak të vonesës së prokurorëve.⁵ Raste të tilla janë identifikuar në gjykatat themelore në Prishtinë, Mitrovicë, Prizren, Ferizaj dhe Gjakovë.⁶ Gjetjet e monitorimit kanë identifikuar gjithashtu 5 raste të vonesave

2 Sipas Kodit të Procedurës Penale, neni 242 par. 4 parasheh se gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës

3 Shënim: Seanca e datës 19 nëntor 2019 në GjTh në Prizren, numër PKR.nr.211/16. Seanca ishte shpallje e aktgjykimit, e cila u vonua për 15 minuta për shkak të vonesës së trupit gjykues.

Raste të tjera:

4 **GjTh në Prishtinë:** PKR. 510/14 (18 tetor 2018), PP. 450-6/2012 (23 janar 2019), PKR.nr.53/17 (22 tetor 2018), PKR.nr.53/17 (5 nëntor 2018), PKR.nr.476/15 (12 nëntor 2018), PKR.nr.111/17 (6 mars 2019), PKR.253/17 (17 dhjetor 2018), PKR.nr.51/14 (26 dhjetor 2018), PKR.227/17 (30 janar 2019), PKR.nr.276/16 (27 shkurt 2019), PKR.198/17 (11 shkurt 2019), PKR.nr.164/17 (3 prill 2019); PKR.nr.519-13 (2 korrik 2019), PKR.nr. 40-18 (7 qershor 2019), PKR.nr.305-16 (14 qershor 2019), PKR.nr.458-16 (30 prill 2019), PKR.nr.314-16 (21 shkurt 2019), PKR.nr.371-17 (3 prill 2019), PKR.nr. 886/13 (06 maj 19), Pkr.nr. 712/14 (06 shkurt 2019), Pkr.nr. 712/14 (1 prill 19), PKR.nr.113/17 (04 dhjetor 2018), PKR.nr.476-15 (12 nëntor 2018).

GjTh në Mitrovicë: P.nr. 101/17 (13 nëntor 2018), PKR. nr. 117/19 (17 janar 2019), P.nr. 147/17 (7 maj 2019),

GjTh në Pejë: PKR-5/18 (19 dhjetor 2018), PKR-5/18 (1 mars 2019),

GjTh në Prizren: PKR-211/16 (19 nëntor 2018),

GjTh në Ferizaj: PP-I nr.17-2017 (9 tetor 2018), P.nr.173/17 (10 dhjetor 2018), P.nr.173/17 (17 janar 19), P.nr.173/17 (18 janar 19), PKR.57/15 (15 tetor 2019), PKR.57/15 (15 tetor 2018), PKR.nr.204/17 (11 dhjetor 2018), PKR.nr.204/17 (5 mars 2019), PKR.nr.204/17 (1 prill 2019), PKR.37/17 (14 dhjetor 2018), PKR.37/17 (31 janar 2019), (19 mars 2019),

5 Shënim: Për shkak se prokurori i çështjes përfaqësonte në një seancë tjetër, seanca e datës 29 nëntor në GjTh në Prizren, në rastin PKR.nr.79/18 kishte filluar me 30 minuta vonesë.

6 **GjTh në Prishtinë:** PKR. 332/17 (24 dhjetor 2018), PKR. nr. 356/17 (30 janar 2019); PKR. nr. 627/15 (15 prill 19), PKR. nr. 627/15 (24 maj 19), PKR. nr. 253/17 (17 dhjetor 2018), PKR. nr. 110-17 (9 nëntor 2018), PKR. nr. 369-16 (22 nëntor 2018), PKR. nr. 18/15 (23 prill 2019);

GjTh në Mitrovicë: P. nr. 67/15 (21 mars 19), P. nr. 210/15 (6 nëntor 2018);


GjTh në Prizren: PKR-79/18 (29 nëntor 2018), PKR-79/18 (15 shkurt 2019);

GjTh në Ferizaj: PKR. 57/15 (15 nëntor 2018), PKR. 57/15 (15 nëntor 2018), PKR. 57/15 (19 nëntor 2018), PKR. 57/15 (20 nëntor 2018), PKR. 57/15 (27 nëntor 2018), PKR-9/18 (24 tetor 2018), PKR. 37/17 (18 mars 2019), PKR. 37-17 (25 prill 2019), PKR. 244/18 (17 prill 2019), PKR. 244/18 (18 prill 2019),

GjTh në Gjakovë: PKR-36/18 (8 tetor 2018); PKR-36/18 (19 tetor 2018); PKR-50/18 (17 tetor 2018), PKR-50/18 (19 tetor 2018),

Trendi i fillimit me kohë apo me vonesë i shqyrtimeve të
seancave në gjykatat themelore në Kosovë

17%
Me Vonesë



83%
Me kohë

Arsyet e fillimit me vonesë të seancave gjyqësore



45%
TRUPI GJYKUES



26%
PROKURORI



5%
MBROJTËSI



14%
I PANDEHURI



3%
I DËMTUARI



7%
TË TJERA

të mbrojtësve,⁷ 13 rasteve të vonesave të të pandehur-ve,⁸ 3 raste të vonesave të të dëmtuarve⁹ dhe 7 raste të fillimit me vonesë për shkaqe të tjera¹⁰.

Vonesa e fillimit të seancave vazhdojnë të shkaktojnë zvarritje të shqyrtimeve dhe gjithashtu, joefikasitet të gjykatave. Gjykatat themelore në Kosovë vazhdojnë të jenë të ngarkuara me numër të madh të lëndëve dhe efikasitet të dobët.

7 **GjTh në Mitrovicë:** P. nr. 129/17 (14 janar 2019), P. nr. 129/17 (20 nëntor 2018), P. nr. 135-18 (07 qershor 19), P. nr. 51/19 (10 maj 19), PKR. nr. 140/17 (25 janar 2019), PKR. nr. 156/17 (29 janar 2019),
GjTh në Prizren: PKR-17/18 (12 mars 2019),
GjTh në Ferizaj: P. nr. 173/17 (21 shkurt 2019), PKR. nr. 204/17 (22 shkurt 2019)

8 **GjTh në Prishtinë:** PKR. nr. 439/15 (14 nëntor 2018), PKR. 610-16 (16 nëntor 2018), PKR. nr. 18-15 (11 mars 2019);

GjTh në Mitrovicë: P. nr. 129/17 (1 mars 2019);

GjTh në Pejë: PKR-5/19, PKR. nr. 111-18 (31 janar 2019);

GjTh në Ferizaj: P. nr. 173/17 (12 tetor 2018);

GjTh në Gjakovë: PKR-36/18 (18 dhjetor 2018), PKR-36/18 (11 shkurt 2019), PKR-36/18 (15 shkurt 2019), PKR-36/18 (19 shkurt 2019), PKR-5/19 (25 qershor 2019).

9 **GjTh në Prishtinë:** PKR. nr. 519-13 (22 nëntor 2018 - Vonesa e përfaqësueseve të ministrisë së shëndetësisë), PKR. nr. 519-13 (28 dhjetor 2018 - Vonesa e përfaqësueseve të ministrisë së shëndetësisë);

GjTh në Ferizaj: PKR. nr. 204/17 (21 dhjetor 2018).

10 GjTh në Prishtinë: PP. 450-6-2012 (19 tetor 2018, probleme teknike);

PKR. nr. 734-15 (27 nëntor 2018 - Mungesa e hapësirave të lira-sallave të gjyqësorisë), PKR. 610-16 (25 qershor 2019- Për shkak të transportit të teakuzuarve, që ndodheshin në paraburgim), PKR. nr. 199/17 (12 nëntor 2018- aktakuza ishte e mangët), PKR. nr. 242/18 (24 maj 19 - Avokati ka kërkuar përjashtimin e kryetares së trupit gjyqësor);

GjTh në Mitrovicë: PKR. nr. 156/17 (29 janar 2019- Seanca filloi me vonesë për arsye se gjykatësi T. P. kishte harruar caktimin e seancës);

GjTh në Ferizaj: PKR. nr. 204/17 (6 nëntor 2018 - salla e zënë).

1.3 Shtyrja e seancave

Shtyrja e seancave gjyqësore është gjetje tjetër e monitorimit e cila vazhdon të jetë evidente në të gjitha gjykatat themelore të Kosovës.

Duke u bazuar në monitorimin e Organizatës Çohu!, **114** seanca janë shtyrë, mosmbajtja e seancave dhe shtyrja e tyre kishte ardhur për shkaqe pothuajse të njëjta me ato që kishin shkaktuar vonesat në fillimin e mbajtjes së seancave gjyqësore.

Trendi i shtyrjes së seancave gjyqësore në gjykatat themelore në Kosovë

20%
Të shtyera



80%
Të mbajtura
me kohë

Ndër arsyet e shpeshta të kësaj shtyrje kishte qenë edhe mungesa e trupit gjykues dhe të të akuzuarve. Mungesa e prokurorëve, e mbrojtësve, e dëshmitarëve dhe mosdorëzimi i shkresave dhe provave të lëndës për palët, kishin qenë arsye e shtyrjes së gjykimeve.

Mungesa e trupit gjykues apo gjykatësit përkatës vazhdon të mbetet shqetësimi kryesor. Duke u bazuar në gjetjet e Organizatës ÇOHU! mbeten të ndryshme arsyet e shtyrjes së seancave gjyqësore për shkak të mungesës së trupit gjykues/gjykatësit në seancë.

Ndër arsyet e shumta është edhe pjesëmarrja e gjykatësve në trajnime dhe seminare të ndryshme, në ditën e planifikuar për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor. Duke u bazuar në këto gjetje, pothuajse të gjitha gjykatat kanë shtyrë seanca për shkak të mungesës së trupit gjykues/gjykatësit të cilët ndodheshin në trajnime e seminare të ndryshme në kohën e paraparë për mbajtjen e shqyrtimeve gjyqësore.

Sipas të dhënave të monitorimit, raste të tilla janë identifikuar në GjTh në Prishtinë,¹¹ GjTh në Pejë,¹² GjTh në Mitrovicë,¹³ GjTh në Ferizaj¹⁴ dhe GjTh në Gjilan.¹⁵

Duke u bazuar në të dhënat e monitorimit, një numër i madh i seancave janë shtyrë për shkak të mungesës së

gjykatësve. Trajnimet dhe seminare për gjykatësit janë të rëndësishme për ngritjen profesionale dhe zhvillimin e shkathtësive të tyre, e të cilat ndihmojnë në cilësinë e trajtimeve të rasteve gjyqësore, mirëpo përshtatja e orarit të mbajtjes së trajnimeve dhe seminareve, e në veçanti gjatë kohës së mbajtjes së seancave, do t'i kontribuonte tutje efikasitetit të gjykatave. Pra gjykatësit duhet ta marrin parasysh rëndësinë e trajtimit të rasteve me më shumë efikasitet, e kjo do të kontribuonte tutje në trajtim me efikas të rasteve dhe rezultate më të mira të gjyqësorit.

Gjetjet e Organizatës Çohu! kanë identifikuar gjithashtu raste të shtyrjes së seancave për shkak se prokurorët kishin qenë të zënë me trajnimet dhe seminare të ndryshme. Vetëm në GjTh në Pejë janë identifikuar 3 raste të tilla kur prokurorët kishin munguar për këto arsye dhe seanca nuk ishte mbajtur pikërisht për shkak të mungesës së tyre.¹⁶

Prokurori kishte munguar edhe për shkaqe të tjera. Shkaqet e mungesës së prokurorëve janë nga më të ndryshmet, duke filluar nga pamundësia e përfaqësimit për shkak të përfundimit të mandatit,¹⁷ mungesa e prokurorëve pa paralajmërim dhe pa shpjegim të arsyeve,¹⁸ për arsye riemërimi¹⁹ apo edhe pushimi,²⁰ e deri te ndërprerja dhe shtyrja e seancave për shkak të mospërgatitjes së prokurorëve, e kjo gjithë mbetet shqetësuese.²¹

11 Prishtinë – Në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me datë 6 dhjetor, ka dështuar të mbahet shqyrtimi gjyqësor. Shkak për mos mbajtjen e seancës ka qenë mungesa e njërit nga anëtarët e trupit gjykues, gjykatësit Mustaf Tahiri, për të cilin u tha se ndodhet në një trajnim zyrtar.

12 Shënim: Seanca në rastin PKR.25/18 e caktuar në GjTh në Pejë për datën 5 nëntor 2018 nuk është mbajtur për shkak se kryetari i trupit gjykues (SylëLokaj) kishte qenë në një trajnim zyrtar.

13 Shënim: Seancat për rastin P.nr. 210/15 të caktuara në GjTh në Mitrovicë për datat 14 dhe 15 mars 2019 nuk janë mbajtur për shkak se kryetari i trupit gjykues (Burim Ademli) kishte qenë në një seminar të organizuar në Istog.

14 Shënim: Seanca në rastin PP. 51/13 e caktuar në GjTh në Ferizaj për datën 13 nëntor 2018 nuk është mbajtur për shkak se anëtarët e trupit gjykues (Hysniye Gashi dhe Sahit Krasniqi) ishin të angazhuar në një tryezë në Gjilan të organizuar nga Gjykata e Apelit dhe OSBE-ja.

15 Shënim: Për shkak të mungesës së njërit prej anëtarëve të trupit gjykues (Berat Spahiu), seanca për rastin PKR. nr. 145/17 për veprën penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar" e cila ishte e caktuar të mbahet me 13 shkurt 2019 në GjTh në Gjilan, u shty për datë 1 prill 2019. Nga gjykata u dhanë sqarime se anëtarët i trupit gjykues i cili nuk ishte prezent në gjykatore, kishte njoftuar se po këtë ditë ai ndodhej në një trajnim, si trajnues për unifikimin e aktgjykimeve në çështjet civile.

16 Shënim: Rasti PKR.nr.44/16 i caktuar të mbahej me 7 nëntor 2018, Rasti PKR.nr.106/17 i caktuar të mbahej me datat 8 dhe 9 nëntor 2018, Rasti PKR.nr.47/18 i caktuar të mbahej me 28 shkurt 2019,

17 Shënim: Seanca në rastin PKR. nr. 96/18 e caktuar për datën 21 maj 2019 në GjTh në Prishtinë, nuk është mbajtur. Kryetari i trupit gjykues Beqir Kalludra, sqaroi për palët dhe publikun se prokurori Halimi e kishte arsyetuar dhe paralajmëruar mungesën e tij, sepse, të njëjtit i kishte kaluar mandati i përfaqësimit si prokuror në Departament për Krime të Rënda, në Prokurorinë Themelore në Prishtinë. Për arsye të njëjta ishte shtyrë edhe seanca për rastin PKR.nr.371-17, edhe pse e caktuar të mbahet me 31 maj 2019 në GjTh në Prishtinë.

18 Shënim: Mungesa e prokurorit Rafet Halimi ishte shkaku i shtyrjes së seancës të datës 26 prill 2019 në GjTh në Prishtinë. Gjykata konstatoi se prokuroria ishte njoftuar me kohe dhe ftesë të rregullt, por se gjykata nuk kishte pranuar ndonjë arsyetim për mungesën e përfaqësimit. Vepra penale ishte "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar".Trupi Gjykues mori vendim qe seanca të shtyhet për një ditë tjetër dhe ajo e radhës u caktua për 18 korrik 2019.

19 Shënim: Seanca në rastin PKR. nr. 371/17 e caktuar në GjTh në Prishtinë për datën 10 maj 2019, nuk është mbajtur për shkak të mungesës së prokurorit Rafet Halimi për të cilin gjykata tha se i njëjti ishte në proces të riemërimit të pozitës së tij, me ç'rast KPK nuk kishte caktuar ndonjë përfaqësues tjetër për këtë seance.

20 Shënim: Seancat e datave 20 dhe 21 maj 2019 për rastin P. Nr 210/15 në GjTh në Mitrovicë nuk janë mbajtur për shkak të mungesës së Prokurorit Njazi Rexha, i cili kishte njoftuar gjykatën se ishte në pushim vjetor. Vepra penale ishte "Përvetësimi në detyrë".

21 Shënim: Shqyrtimi i datës 23 prill 2019 në të cilin ishte planifikuar të mbahej fjala përfundimtare në rastin ku akuzohet ish- Kryetari i Komunës së Skenderajt Sami Lushtaku dhe të tjerët, nuk është mbajtur. Arsye e mosmbajtjes së kësaj seance në rastin PKR. nr. 18/15 për veprën penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar", "Mashttrim" në GjTh në Prishtinë ishte mospërgatitja e prokurores së rastit Florije Shamolli.

Arsyet e shtyrjes së seancave gjyqësore



26%

PROKURORI



12%

TRUPI GJYKUES



30%

PANDEHURI



15%

MBROJTËSI



3%

DËSHMITARI



1%

EKSPERTI



5%

DËMTUARI



8%

TË TJERA



114 seanca

janë shtyrë, mosmbajtja e seancave dhe shtyrja e tyre kishte ardhur për shkaqe pothuajse të njëjta me ato që kishin shkaktuar vonesat në fillimin e mbajtjes së seancave gjyqësore.



Duke u bazuar në gjetjet e Organizatës
ÇOHU! në gjykatat e monitoruara për
periudhën njëvjeçare janë ndërprerë

30 seanca

për arsyet të cilat përmenden në **Nenin 312 par. 1**

Mungesa e të pandehurve²² dhe mbrojtësve²³ të tij, të dëmtuarve²⁴ dhe dëshmitarëve²⁵, e po ashtu mosdorëzimi i të gjitha shkresave të lëndës për palën,²⁶ kanë qenë gjithashtu shkaqe të shtyrjes së seancave.

Të gjitha këto shkaqe kanë shkaktuar shtyrje të seancave, që si pasojë kanë prodhuar zvarritje të proceseve gjyqësore dhe mungesë të efikasitetit të gjyqësorit.

1.4 Ndërprerja e seancave gjyqësore

Neni 312 i Kodit të Procedurës Penale të Republikën e Kosovës parasheh tërësi të rregullave të cilat mundësojnë zgjidhjen e çështjeve penale me efikasitet dhe efektivitet. Organizata Çohu! ka identifikuar se këto rregulla nuk respektohen gjithmonë nga organet përkatëse.

Dispozita e këtij neni (312), në paragrafin 3 parasheh respektimin e një afati 8-ditor të vazhdimit të seancave gjyqësore pas ndërprerjes së saj, e gjithashtu situatën dhe rastet kur shqyrtimi gjyqësor i ndërprerë mund ta tejkalojë këtë afat 8-ditor.

Parimisht sipas kësaj dispozite (neni 312), afati 8-ditor duhet të jetë i respektueshëm si afat në rastet kur shqyrtimi gjyqësor ndërpritet për pushim për shkak të kalimit të orarit të punës, për të lejuar një kohë të shkurtër që të sigurohet ndonjë provë apo edhe për përgatitjen e akuzës apo mbrojtjes.²⁷ Pra, ndërprerja e shqyrtimit gjyqësor si rregull bëhet për një kohë të shkurtër.

Sipas monitorimit të Organizatës ÇOHU! janë të rralla rastet kur është aplikuar dhe është respektuar ky afat 8-ditor. Tutje sipas gjetjeve, gjykatat më shumë kishin vendosur ta aplikojnë paragrafin pasues, i cili ka të bëjë me mosrespektimin e afatit 8-ditor dhe kërkon aplik-

22 Shënim: Arsyeya e shtyrjes se seancës e datës 10 prill 2019 për rastin PKR. nr. 58/18 në GjTh në Gjakovë ishte mungesa e të akuzuarës, e cila përmes një parashtrëse kishte lajmëruar gjykatën se gjendet për pushime në Zvicër. Po ashtu edhe mbrojtësi i të akuzuarës, avokati Esat Gutaj ka lajmëruar gjykatën për mospraninë e tij, duke thënë se në këtë ditë ka një rast tjetër në GjTh në Prizren. Vepra penale ishte "Përvetësimi në detyrë".

23 Shënim: Arsyeya e shtyrjes se seancës së datës 24 janar 2019 për rastin PKR.nr.79/18 në GjTh në Prizren ishte për shkakun se mbrojtësi i të akuzuarit, avokati Hazër Susuri, me parashtrësen e 23 janarit 2019, ka kërkuar që seanca e paraparë për sot, të shtyhet për një ditë tjetër. Të njëjtit i nevojitet kohë për tu përgatitur dhe gjithashtu ka kërkuar që të pajiset me të gjitha shkresat e lëndës, të cilat nuk i posedon i mbrojturi i tij. Vepra penale nga ky rast ishte "Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar".

24 Shënim: Arsyeya e shtyrjes se seancës së datës 25 janar 2019 për rastin PKR. nr. 99/18 në GjTh në Prizren ishte për shkakun se këtë seancë ka munguar e dëmtuara. Meqenëse nuk kishte kushte ligjore për të vazhduar shqyrtimi kryesor, gjykatësja seancën e radhës e ka caktuar pas disa muajsh, më 2 tetor 2019. Vepra penale nga ky rast ishte "Shpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar".

25 Shënim: Në seancën e datës 14 dhjetor 2018, ishin të ftuar dëshmitarët, të cilët edhe nuk ishin paraqitur në shqyrtim. Kjo seancë me numër PKR. nr. 17/18 për veprën penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar" nuk është mbajtur dhe është shtyrë për një datë tjetër.

26 Arsyeya e shtyrjes se seancës e datës 15 prill 2019 për rastin PKR.nr.19/19 në GjTh në Prizren ishte për faktin se i akuzuari i rasti, nuk kishte pranuar aktakuzën dhe shkresat e lëndës. Vepra penale ishte "Keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar".

27 Kodi i Procedurës Penale, paragrafi 3 i nenit 312; <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>

imin e nenit paraprak të Kodit të Procedurës Penale, atij 311.²⁸

Gjatë monitorimit të seancave gjyqësore, Organizata Çohu! ka identifikuar raste të mosrespektimit të kësaj dispozite ligjore, konkretisht Nenit 312.

Duke u bazuar në gjetjet e Organizatës ÇOHU! në gjykatat e monitoruara për periudhën njëvjeçare janë ndërprerë 30 seanca, për arsytet të cilat përmenden në Nenin 312 par. 1, me ç'rast seancat e radhës nga ndërprerja e seancës gjyqësore ishin caktuar me vonesë, duke mos respektuar kështu afatin tetëditor i paraparë në Nenin 312 të KPK-së. Rastet e tilla janë identifikuar në gjykatat themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjakovë, Pejë, Gjiilan dhe Prizren.²⁹

Disa nga shkaqet e mosrespektimit të këtij rregulli janë: numri i madh i lëndëve në procedim nga gjykatat, gjykimet e tjera të parashikuara për datat eventuale, mungesa e koordinimit të trupit gjykues për datën e përshtatshme apo edhe për shkaqe të neglizhencës së vetë gjykatësve apo defekteve të tyre profesionale.³⁰

Ndërprerja e seancave gjyqësore dhe caktimi i seancës pasuese me vonesa që zgjasin me javë e muaj të tërë shkakton shtyrjen e seancave dhe zvarritjen e procesit gjyqësor.

Mosrespektimi i dispozitave ligjore vazhdon të ketë pasojë në tej zgjatjen e shqyrtimeve gjyqësore, si rezultat i mosrespektimit të këtyre dispozitave ligjore kemi shkelje të drejtave të njeriut, ndër këto e drejta për gjykim të drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme.

1.5 Shkelja e afateve ligjore

Zhvillimi i procesit gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme është koncept themelor juridik, i cili është i paraparë edhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Neni 6 i kësaj Konvente thotë: *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj....”*³¹. Gjithashtu dispozitat e Republikës së Kosovës parashohin gjykimin brenda afateve të arsyeshme.

Gjatë monitorimit të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar, Organizata ÇOHU! ka identifikuar raste të shkeljes së dispozitave ligjore të cilat kanë të bëjnë me afatet ligjore të procedimit të rasteve.

Me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës janë paraparë afatet kohore brenda të cilave duhet të mbahen seancat gjyqësore. Nga momenti i

28 Paragrafi 3 I nenit 312 I Kodit të Procedurës Penale: Kur shqyrtimi gjyqësor nuk mund të vazhdojë para të njëjtit trup gjykues, ose kur ndërprerja e tij zgjat më tepër se tetë (8) ditë, atëherë zbatohen dispozitat nga neni 311 i këtij Kodi. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>.

29 **GjTh në Prishtinë:** PKR.nr.476/15 (12 nëntor 2018 pas ndërprerjes seanca e radhës u shty për kohë të pacaktuar), PKR.nr. 439/15 (24 dhjetor 2018, pas ndërprerjes seanca e radhës u caktua për datën 17 janar 2019), PKR.nr. 3/18 (5 mars 2019, seanca e radhës u caktua për dt. 3 prill 2019), PKR.nr. 397/17 (5 dhjetor 2018, seanca e radhës u caktua për dt. 17 janar 2019), PKR.nr. 149/17 (16 prill 2019, seanca e radhës u caktua për dt. 15 korrik 2019), PKR.nr. 269/16 (19 shkurt 2019, e radhës u caktua për dt. 26 mars 2019), PKR.nr. 458/16 (20 shkurt 2019, seanca e radhës u caktua për dt. 20 mars 2019), PKR.nr.16/18 (17 prill 2019, e radhës u caktua për 16 maj 2019)

GjTh në Pejë: PKR.nr. 168/16 (19 nëntor 2018, seanca e radhës u caktua për datën 3 dhjetor 2018), PKR.nr. 5/18 (19 dhjetor 2018, seanca e radhës u caktua për dt. 30 janar 2019), PKR.nr. 106/17 (17 janar 2019, seanca e radhës u caktua për 18 janar 2019), PKR.nr. 106/17 (20 shkurt 2019, seanca e radhës u caktua me dt. 19 mars 2019), PKR.nr. 50/18 (11 shkurt 2019, seanca e radhës u caktua për dt.4 shkurt 2019), PKR.nr.5/18 (1 mars 2019, seanca e radhës u caktua për dt. 19 prill 2019), PKR.nr. 168/16 (4 mars 2019, seanca e radhës është caktuar për dt.27 maj 2019), PKR.nr. 47/18 (28 mars 2019, seanca e radhës u caktua për dt. 12 prill 2019), PKR.nr. 26/18 (11 prill 2019, seanca e radhës u caktua për dt.12 prill 2019), PKR.nr. 26/18 (13 prill 2019, seanca e radhës u caktuar për 23 maj 2018)

GjTh në Prizren: PKR.nr. 87/18 (23 prill 2019, seanca e radhës u caktua për dt. 31 maj 2019), PKR.nr. 91/18 (10 maj 2019, seanca e radhës u caktua për dt. 30 maj 2019), PKR.nr. 119/18 (17 maj 2019, seanca e radhës u caktua për 3 korrik 2019)

GjTh në Ferizaj: PKR.nr. 37/17 (14 dhjetor 2018, seanca e radhës u caktua për dt. 25 janar 2018), PKR.nr. 37/17 (16 janar 2019, seanca e radhës u caktuar për 4 shkurt 2019), PKR.nr. 204/17 (6 maj 2019, e radhës u caktua për dt. 8 maj 2019)

GjTh në Gjakovë: PKR.nr. 36/18 (23 janar 2019, seanca e radhës u caktua për dt. 11 shkurt 2019), PKR.nr. 58/18 (6 maj 2019, seanca e radhës u caktua për dt. 31 maj 2019)

GjTh në Gjiilan: PKR.nr.129/18 (8 maj 2019, e radhës u caktua me dt.5 qershor 2019)

30 Në GjTh në Prishtinë, rasti me numër të lëndës PKR.nr. 149/17 pas ndërprerjes së seancës të mbajtur me datë 16 prill 2019, seanca e radhës u caktua me datë 15 korrik 2019, për shkak se trupi gjykues nuk ka mundur të koordinohet për një datë më të përafërt. Në GjTh në Pejë, rasti me numër të lëndës PKR.nr. 106/17 pas ndërprerjes së seancës të mbajtur 20 shkurt 2019 për shkak të përfundimit të orarit të punës, seanca e radhës u caktua me datë 19 mars 2019. Në GjTh në Gjakovë, rasti me numër të lëndës PKR.nr. 36/18 pas ndërprerjes së seancës të mbajtur me 23 janar 2019 për shkak se njëri nga anëtarët e trupit gjykues kishte një gjykim tjetër, seanca e radhës u caktua me datë 11 shkurt 2019. Në GjTh në Prizren, rasti me numër të lëndës PKR.nr. 87/18 pas ndërprerjes së seancës të mbajtur me datë 23 prill 2019 për shkak të përfundimit të orarit të punës, seanca e radhës është caktuar me datë 31 maj 2019. Në GjTh në Ferizaj, rasti me numër të lëndës PKR.nr. 37/17 pas ndërprerjes së seancës të mbajtur me datë 14 dhjetor 2018, seanca e radhës u caktua me datë 25 janar 2019.

31 Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6: https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_SQL.pdf

pranimit të rastit në gjykatë, procedimi dhe shqyrtimi i rastit është kategorizuar në shqyrtimin e parë apo fillestar, atë dytësor kur gjykata konsideron të nevojshëm si dhe në shqyrtimin kryesor.

Në Nenin 242 të Kodit të Procedurës Penale është paraparë afati i trajtimit të rasteve të tilla nga momenti i pranimit të rasteve në gjykatë. Paragrafi 4 i këtij Neni parasheh caktimin dhe mbajtjen e shqyrtimit fillestar gjyqësor brenda 30 ditësh nga momenti i ngritjes së aktakuzës, ndërsa paragrafi 5 parasheh afatin 15-ditor të caktimit dhe mbajtjes së shqyrtimit fillestar prej ngritjes së aktakuzës në rastet me paraburgim.³²

Afatet janë paraparë gjithashtu për shqyrtimin dytësor dhe atë kryesor si dhe për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor. Derisa mbajtja e shqyrtimit dytësor është paraparë jo më herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se katërdhjetë (40) ditë pas shqyrtimit fillestar, shqyrtimi kryesor është paraparë të mbahet brenda një muaji nga shqyrtimi dytësor.

Përkundër faktit se Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës parasheh afate të rrepta sa i përket caktimit të seancave gjyqësore, Organizata ÇOHU! ka identifikuar shtyrje të afateve në caktimin dhe shqyrtimin e rasteve nga monitorimi i rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Nga gjithsej 242 rastet e monitoruara me 575 seanca gjyqësore për periudhën 1 tetor 2018 – 30 shtator 2019 në gjykatat themelore në Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj, Pejë, Gjakovë, Prizren dhe Gjilan, Organizata ÇOHU! ka identifikuar shkelje të afateve procedurale pothuajse në të gjitha rastet, varësisht nga faza e procedimit (nga momenti i pranimit të rastit në gjykatë, caktimi dhe mbajtja e shqyrtimit fillestar, dytësor dhe atij kryesor, si dhe përfundimi dhe shpallja e aktgjykimit).

1.5.1 Shkelja e afateve në shqyrtimin fillestar

Duke u bazuar në të dhënat e monitorimit Organizata ÇOHU! ka identifikuar **84** raste të tejkalimit të afatit për caktimin e shqyrtimit fillestar (brenda tridhjetë (30) ditësh) nga data e pranimit në gjykatë.

Rastet më serioze të shkeljes së këtij afati janë identifikuar në të shtatë gjykatat e monitoruara, në Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj, Pejë, Gjilan, Prizren dhe Gjakovë.

Rasti më flagrant i shkeljes është identifikuar në GjTh në Mitrovicë, rast i cili përfshin periudhën prej 1396 ditësh nga momenti i pranimit të tij në gjykatë³³. Shkelje e rëndë është identifikuar edhe në GjTh në Prishtinë që përfshin periudhën prej 1209 ditësh nga momenti i pranimit të rastit në gjykatë³⁴.

Raste të shkeljes së shqyrtimit fillestar janë identifikuar edhe në gjykatat në Pejë, Gjilan, Gjakovë.³⁵

1.5.2 Shkelja e afateve në shqyrtimin dytësor

Sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, pas shqyrtimit fillestar në periudhën jo më herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë duhet të mbahet shqyrtimi nëse Gjykata e konsideron të nevojshme mbajtjen e tij.

Duke u bazuar në të dhënat e monitorimit, ÇOHU! ka identifikuar raste kur nuk është respektuar afati procedural në lidhje me caktimin e shqyrtimit dytësor në gjykatat themelore në Prishtinë, Pejë, Gjilan, Ferizaj, Prizren, Gjakovë.

32 Kodi i Procedurës Penale, neni 242 par.4 dhe par.5

33 Shënim: **GjTh në Mitrovicë**, Rasti P.nr.67/15, i pranuar në gjykatë me datë 14 prill 2014, ndërsa shqyrtimi fillestar është mbajtur me dt. 6 shkurt 2018

34 Shënim: **GjTh në Prishtinë**, Rasti PKR.nr.439/15, i pranuar në gjykatë me datë 31 korrik 2015, ndërsa shqyrtimi fillestar mbajtur me dt. 22 nëntor 2018

35 Shënim: **GjTh në Gjilan**, Rasti PKR.nr.189-17, i pranuar në gjykatë me datë 26 prill 2016, ndërsa shqyrtimi fillestar është mbajtur me dt. 14 dhjetor 2017.

GjTh në Pejë, Rasti PKR-25/18, i pranuar në gjykatë me dt. 26 mars 2018, ndërsa shqyrtimi fillestar është mbajtur me dt. 17 janar 2019. **GjTh në Gjakovë**, Rasti P.nr.214/18, i pranuar në gjykatë me 15 mars 2018, ndërsa shqyrtimi fillestar është mbajtur me dt. 26 shkurt 2019.

Rastet më të shënuara të shkeljes së afatit për caktimin e shqyrtimit dytësor janë identifikuar në GjTh në Prishtinë³⁶ dhe GjTh në Ferizaj³⁷.

1.5.3 Shkelja e afateve në shqyrtimin kryesor

Afati tjetër lidhur me procedimin e rastit në fazat e shqyrtimit është edhe ai për shqyrtimin kryesor. Sipas Kodit të Procedurës Penale, Neni 285 paragrafi 2 lidhur me Nenin 254 paragrafi 5, gjykatësi i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton fillimin e shqyrtimit gjyqësor brenda një (1) muaji nga shqyrtimi i dytë ose nga urdhri i fundit i lëshuar nga Neni 254, paragrafi 5.

Monitorimi i Çohul ka identifikuar raste të shkeljes së afatit të tillë në të shtatë (7) gjykatat e mbuluara me monitorim (Prishtinë, Pejë, Mitrovicë, Ferizaj Gjilan, Prizren dhe Gjakovë).

Sipas të dhënave të monitorimit, rastet në të cilat është tejkaluar më së shumti afati i mbajtjes së shqyrtimit kryesor nga data e mbajtjes së atij dytësor, janë identifikuar në GjTh në Prishtinë – rasti i parë përfshin periudhën kohore prej 353 ditë³⁸, rasti i dytë përfshin periudhën kohore prej 370 ditë³⁹ ndërsa rasti i tretë i identifikuar në GjTh në Ferizaj përfshin periudhën kohore prej 475 ditë⁴⁰.

1.5.4 Shkelja e afateve lidhur me përfundimin e shqyrtimit kryesor

Përfundimi i shqyrtimit kryesor gjithashtu është i rregulluar me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Neni 314 parasheh që shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundojë brenda nëntëdhjetë ditësh, përkatësisht njëqind e njëzet (120) ditëve prej seancës së parë të shqyrtimit gjyqësor.

Nga gjithsej 575 rastet me 242 seancat e monitoruara për periudhën 1 tetor 2018 – shtator 2019 në gjykatat themelore në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Ferizaj, Prizren, Gjakovë dhe Gjilan, 52 të tilla kanë përfunduar me aktgjykim në shkallën e parë, ndërsa 523 të tjera vazhdojnë të mbesin në procedim.

Në 52 rastet e përfunduara, në 17 raste nuk është respektuar afati 120-ditor i përfundimit të shqyrtimit gjyqësor. Duke u bazuar në të dhënat e monitorimit të rasteve, shkelje të afatit lidhur me përfundimin e shqyrtimit gjyqësor ka pasur në gjykatat e monitoruara në Prishtinë, Mitrovicë Pejë, Gjilan, Ferizaj, Prizren dhe Gjakovë.

Nga gjetjet e monitorimit, rastet më të rënda të shkeljes së afatit lidhur me kohëzgjatjen e një shqyrtimit gjyqësor kanë ndodhur në GjTh në Prishtinë⁴¹ dhe GjTh në Gjilan⁴².

Shkelja e afateve dhe kohëzgjatja e një shqyrtimi gjyqësor në GjTh në Prishtinë ka shkuar deri në 514 ditë, ndërsa në Gjilan deri 273 ditë.

36 Shënim: GjTh në Prishtinë, PKR.nr.734/15. Derisa shqyrtimi fillestar ishte mbajtur me 4 prill 2016, shqyrtimi dytësor është mbajtur me 12 korrik 2017, 463 ditë pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar.

37 Shënim: GjTh në Ferizaj, Rasti PKR.nr. 41/18. Derisa shqyrtimi fillestar ishte mbajtur me 26 shkurt 2018, shqyrtimi dytësor është caktuar dhe mbajtur me 30 prill 2019, 425 ditë pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar.

38 Shënim: Rasti PKR.nr.53-17. Derisa shqyrtimi dytësor është mbajtur më dt. 31 maj 2017, shqyrtimi kryesor është mbajtur me dt. 18 maj 2018.

39 Shënim: Rasti PKR.nr.166-17. Derisa shqyrtimi dytësor është mbajtur me dt. 23 nëntor 2017, shqyrtimi kryesor është mbajtur me dt. 29 nëntor 2018.

40 Shënim: Rasti PKR.37-17. Derisa shqyrtimi fillestar është mbajtur më 18 korrik 2017, shqyrtimi kryesor është mbajtur më dt. 1 nëntor 2018.

41 Shënim: Rasti PKR.nr.734-15. Derisa shqyrtimi kryesor kishte filluar me 11 shtator 2017, aktgjykimi ishte shpallë me 8 shkurt 2019, 514 ditë pas fillimit të shqyrtimit kryesor, duke mos u respektuar dispozitat procedurale të cilat parashohin kohëzgjatjen e shqyrtimit kryesor prej 90 përkatësisht 120 ditësh, siç përcakton neni 314 paragrafi 1.1 dhe 1.2 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës;

Shënim: Rasti PKR.nr.369-16. Derisa shqyrtimi kryesor kishte filluar me 11 qershor 2018, aktgjykimi ishte shpallë me 24 prill 2019, 312 ditë pas fillimit të shqyrtimit kryesor.

42 Shënim: Rasti PKR.nr.189-17. Derisa shqyrtimi kryesor kishte filluar me 20 mars 2018, aktgjykimi ishte shpallë me 19 dhjetor 2018, 273 ditë pas fillimit të shqyrtimit kryesor.

Duke u bazuar në të dhënat e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës, në periudhën nga viti 2000–2017 në gjykatat e Kosovës janë vjetërsuar



20.548 lëndë penale.

Organizata Çohu! konsideron se shkelja e afateve të tilla dhe mosrespektimi i tyre ndikon në efikasitetin e gjyqësorit për trajtimin e lëndëve brenda një afatit të arsyeshëm. Njëkohësisht, shkelja e dispozitave procedurale vazhdon të ketë pasoja në tejzgjatjen e shqyrtimeve gjyqësore dhe grumbullimin e vazhdueshëm të lëndëve.

1.6 Parashkrimi i lëndëve

Parashkrimi i ndjekjes penale dhe ekzekutimit të sanksioneve ka të bëjë me kalimin e afatit të paraparë me ligj pas të cilit nuk mund të ndërmerret ndjekja penale dhe personit nuk mund t'i shqiptohet dënimi për veprën penale të cilën e ka kryer. Kodi i Penal i Republikës së Kosovës shprehimisht parasheh afate pas të cilave nuk mund të ndërmerret ndjekja penale.

Parashkrimi apo vjetërsimi i rasteve në prokurori dhe gjykata është një ndër problemet e vazhdueshme që karakterizon sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës. Arsytet e parashkrimit janë të ndryshme, qoftë për shkaqe dhe pengesa objektive, qoftë për fajin e prokurorëve dhe gjykatësve si pasojë e neglizhencës apo qëllimisht.

Trendi i parashkrimit të lëndëve penale është rritur nga viti në vit. Duke u bazuar në të dhënat e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës, në periudhën nga

viti **2000–2017** në gjykatat e Kosovës janë vjetërsuar **20.548 lëndë penale**.

Në bazë të të dhënave statistikore të cilat i disponon Këshilli Gjyqësor i Kosovës, vetëm gjatë vitit 2018 parashkrimi relativ ka arritur në 148 lëndë ndërsa parashkrimi absolut ka arritur në 1,972 lëndë në Departamentin e Përgjithshëm dhe në 50 lëndë në Departamentin e Krimeve të Rënda⁴³.

Organizata Çohu! kishte dërguar tetëdhjetë (80) lëndë në Zyrën e Prokurorit Disiplinor (ZPD), me ç'rast tetë (8) lëndë kanë shkuar në komisionet përkatëse për trajtim të mëtutjeshëm mirëpo asnjëherë nuk është marrë ndonjë përgjigje se çfarë masa kanë ndërmarrë komisionet disiplinore.

Duke u bazuar në të dhënat e KGJK-së dhe KPK-së si dhe hulumtimeve të Organizatës Çohu! nuk është identifikuar ndonjë ndëshkim i gjykatësve dhe prokurorëve si pasojë e neglizhencës të tyre dhe numrit të madh të rasteve të parashkruara. Deri më sot nuk ka pasur asnjë rast që një gjykatës ose prokuror të jetë shkarkuar për shkak se ka lejuar vjetërsimin e lëndës.

Në mesin e lëndëve të cilat janë vjetërsuar ka edhe lëndë që i përkasin Kapitullit të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK): “Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare”, lëndë këto të cilat organet për-

43 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 100 par. 8, parasheh se parashkrimi absolut ka arritur në rast se kalohet dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.

katëse kanë pasur për detyrë t'i trajtojnë me prioritet. Vetëm gjatë viteve 2013-2018 në gjykatat e Republikës së Kosovës janë parashkruar 58 lëndë të kësaj natyre, prej tyre 8 në aspektin relativ ndërsa 50 në aspektin absolut.

Gjatë monitorimit të gjykatave, Organizata Çohu! për periudhën 1 tetor 2018 – 30 shtator 2019 ka hasur në 9 raste të parashkrimit në GjTh në Prishtinë⁴⁴, Prizren⁴⁵, Gjakovë⁴⁶, Gjiilan⁴⁷ dhe Pejë⁴⁸. Në Gjykatën Themelore në Prishtinë, rasti me numër të lëndës PKR.nr. 886/13, ku të akuzuar ishin disa zyrtarë nga Ministria e Drejtësisë, ka rezultuar me aktgjykim refuzues për veprën penale të korrupsionit “Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar” nga Neni 422 i KPRK-së, për shkak të arritjes së parashkrimit absolut të veprës penale.⁴⁹ Gjykata Themelore në Prizren po ashtu ka shpallur aktgjykim refuzues ndaj ish-kryetarit të Dragashit, për shkak të arritjes së parashkrimit absolut të veprës penale “Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar”⁵⁰.

Ndonëse kemi një numër të madh të lëndëve që po parashkruhen nga viti në vit, sipas zyrtarëve të drejtësisë vjetërsimi i lëndëve ka ndodhur për disa arsye, ndër të cilat përmendet numri i vogël i gjykatësve dhe numri i madh i lëndëve.

Pas plotësimit dhe ndryshimit të Kodit Penal të Republikës së Kosovës i cili ka hyrë në fuqi më 14 janar 2019, afati i parashkrimit është zgjatur nga 2 në 4 vjet për veprat penale të dënueshme deri në 1 vit burgim ose dënim me gjobë, nga 3 në 6 vjet për veprat penale të dënueshme me më shumë se një vit burgim, nga 5 në

10 vjet për veprat penale të dënueshme me më shumë se 3 vjet burgim, nga 15 në 20 vjet për veprat penale të dënueshme me më shumë se 5 vjet burgim, ndërsa për veprat penale të dënueshme me burgim të përjetshëm parashkrimi mbetet njësoj, pra 30 vjet.⁵¹

Parashkrimi apo vjetërsimi i një numri të madh të lëndëve të cilat nuk marrin epilugun për shkak të kalimit të afatit vazhdon t'u kushtojë qytetarëve me mungesë të trajtimit të rasteve të tyre dhe shkelje të të drejtave. E gjithë kjo, përveç që rezultojnë me mungesë të rezultateve të prokurorive dhe gjykatave gjithashtu vazhdon të thellojë humbjen e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

1.7 Përfaqësimi i aktakuzave dhe papërgatitja e prokurorëve

Përfaqësimi i aktakuzave nga ana e prokurorisë vazhdon të përcillet me probleme të shumta pothuajse në të gjitha gjykatat themelore.

Duke u bazuar në gjetjet e Organizatës Çohu!, ndër shqetësimet kryesore vazhdon të mbetet papërgatitja e prokurorëve gjatë përfaqësimit të aktakuzave. Ndërrimi i vazhdueshëm i prokurorëve gjatë përfaqësimit të aktakuzave si dhe numri i pamjaftueshëm i tyre në raport me numrin e lëndëve, përkundër rritjes së numrit të prokurorëve, vazhdojnë të mbeten probleme të tjera të cilat pamundësojnë përfaqësimin e denjë dhe profe-

44 **GjTh në Prishtinë**, Rasti me numër të lëndës PKR.nr. 111/18. Me datë 29 janar 2019 është shpallur aktgjykim refuzues ndaj katër zyrtarëve të Agjencisë Kosovare të Akreditimit për shkak të arritjes së parashkrimit absolut për veprat penale të korrupsionit.

Prishtinë, Rasti PKR.nr.18/15. Me datë 20 maj 2019 është shpallur aktgjykim refuzues ndaj dy të akuzuarve për shkak të arritjes së parashkrimit absolute të veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve” nga neni 398 i KPRK-së.

Prishtinë, Rasti PKR.nr. 53/17. Me datë 5 nëntor 2018 është shpallur aktgjykim refuzues për veprat penale të korrupsionit.

45 **GjTh në Prizren**, Rasti PKR.nr. 94/18. Me datë 14 mars 2019, për shkak të arritjes së parashkrimit është pushuar procedura penale ndaj zyrtarit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

46 **GjTh në Gjakovë**, Rasti PKR.nr. 36/18. Me datë 23 janar 2019, është pushuar procedura penale ndaj dy të akuzuarve për shkak të arritjes së parashkrimit relativ të veprës penale “Veprimtari e pandërgjegjshme ekonomike” nga neni 285 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

47 **GjTh në Gjiilan**, Rasti PKR.nr. 189/17. Me datë 19 dhjetor 2019, është shpallur aktgjykim refuzuar për pikën 4 të aktakuzës.

48 **GjTh në Pejë**, Rasti PKR.nr. 111/18. Me datë 31 janar 2019, është pushuar procedura penale për shkak të arritjes së parashkrimit relativ të veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve” nga neni 398 i KPRK-së.

49 Shënim: **GjTh në Prishtinë**, PKR.nr.886/13. Me datë 22 maj 2019 është shpallur aktgjykim refuzues ndaj dy zyrtarëve të Ministrisë së Drejtësisë për shkak të arritjes së parashkrimit absolute të veprës penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 të KPRK-së.

50 Shënim: **GjTh në Prizren**, PKR.nr. 10/18. Me datë 9 tetor 2018 është shpallur aktgjykim refuzues ndaj ish-kryetarit të Dragashit, Selim Junuzi për shkak të arritjes së parashkrimit absolute të veprës penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 të KPRK-së.

51 KPRK me ndryshimet pasuese, Neni 99 “Parashkrimi i veprës penale”: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2852>

sional të aktakuzave të prokurorëve gjatë zhvillimit të shqyrtimeve gjyqësore.

Sipas dispozitave ligjore dhe etike, Prokurori i Shtetit gjatë ushtrimit të funksionit të tij duhet të jetë profesional, të zbatojë standarde të larta të punës, të jetë i pavarur, efikas dhe detyrën e tij duhet ta ushtrojë me dinjitet e përgjegjësi.⁵²

Papërgatitja e prokurorëve për përfaqësimin e aktakuzave dhe argumentimin e pretendimeve të tyre të paraqitura në po këto akte akuzuese, bie ndesh me dispozitat ligjore dhe etike, ato të KPRK-së, Ligjit për Prokurorin e Shtetit si dhe Kodin e etikës dhe sjelljes profesionale të prokurorëve.⁵³

Gjatë monitorimit të seancave gjyqësore të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, Organizata Çohu! ka identifikuar raste të papërgatitjes së prokurorëve gjatë përfaqësimit të aktakuzave. Në seancën për veprën penale “Keqpërdorim i detyrës dhe autoritetit zyrtar”, të mbajtur në GjTh në Pejë, derisa zhvillohej seanca kryesore, pas përfundimit të administrimit të provave, prokurorja e rastit kishte kërkuar shtyrjen e seancës për fjalën përfundimtare për një datë tjetër për shkak se nuk ishte e përgatitur ta vazhdojë tutje shqyrtimin. Seanca zhvillohej më 19 tetor të vitit 2018, derisa me kërkesën e prokurores, për shkak të papërgatitjes, seanca ishte shtyrë për datën 3 dhjetor.⁵⁴

Ndërrimi i prokurorëve gjatë përfaqësimit të aktakuzave është problem tjetër që vazhdon t'i kontribuojë mungesës profesionale dhe përfaqësimit të dobët të prokurorisë në argumentimin dhe mbështetjen e akuzave.

Gjatë monitorimit janë identifikuar raste të ndërrimit të prokurorëve gjatë përfaqësimit të aktakuzave pothuajse në të gjitha gjykatat themelore.

Prishtina vazhdon të ketë ndërrimet më të shpeshta të aktakuzave. Monitorimi i Organizatës Çohu! ka identifikuar gjithsej 28 raste të ndërrimit të prokurorëve. Edhe pse aktakuza ishte ngritur nga një prokuror, ajo ishte përfaqësuar në gjykatë nga prokurorë të tjerë.⁵⁵

Madje, duke u bazuar në monitorim, kemi raste kur në përfaqësimin e një aktakuze janë ndërruar tre prokurorë të ndryshëm.⁵⁶

Sipas po këtyre gjetjeve, janë identifikuar rastet kur prokurorë nga Departamenti për të Mitur kanë përfaqësuar aktakuza të natyrës së korrupsionit. Seanca ishte zhvilluar në Gjykatën Themelore në Gjakovë lidhur me veprën penale “Keqpërdorim i detyrës dhe autoritetit zyrtar”.⁵⁷

52 Ligji për Prokurorin e Shtetit, me ndryshimet pasuese: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2710>; Kodi i etikës dhe sjelljes profesionale për prokurorë - <http://www.kpk-rks.org/sistemi/121/kodi-i-etiks-profesionale-/121>;

53 Ibid.

54 Shënim: Rasti PKR. nr. 168/16, mbajtur me 19 tetor të vitit 2018 në Gjykatën themelore në Pejë, vepra penale “Keqpërdorim i Pozitës dhe autoritetit zyrtar në të cilën i akuzuar ishte ish Kryetari i Komunës së Klinës Sokol Bashota.

55 Disa nga rastet e identifikuar në Prishtinë janë:

Rasti PP/I.nr.197/2014 në **GjTh në Prishtinë**. Derisa aktakuzën ka ngritur prokurorja Fikrije Fejzullahu, atë ka përfaqësuar në seancat gjyqësore Kujtim Munishi; Rasti PP.nr.519/2013 në **GjTh në Prishtinë**. Aktakuzën kishte ngritur prokurori Iliaz Beqiri ndërsa kishte përfaqësuar në seancat gjyqësore prokurorja Merrushe Llugin;

Rasti PKR-630/2016 në **GjTh në Prishtinë**. Derisa aktakuzën ka ngritur prokurorja Drita Hajdari, atë ka përfaqësuar në seancat gjyqësore Besa Limani;

Rasti PKR.198-17 në **GjTh në Prishtinë**. Derisa aktakuzën ka ngritur prokurorja Habibe Salihu, atë ka përfaqësuar në seancë Rafet Halimi;

Rasti PKR. 148-18 në **GjTh në Prishtinë**. Përpilues i aktakuzës ishte prokurorja Habibe Salihu dhe me kalimin e saj në Prokurorinë Speciale, ky rast kishte kaluar te prokurori Rafet Halimi.

Rasti PKR.nr. 204/18 në **GjTh në Prishtinë**. Derisa përpilues i aktakuzës është prokuror Naim Abazi, atë e përfaqësoj prokurori Atdhe Dema për shkak se përpiluesi i aktakuzës ishte në pushim vjetor.

56 Shënim: Në lëndën me numër PKR. 371/17, në të cilën e akuzuar për përvetësim në detyrë është E. D, dy prokurorët të cilët kishin pasur rastin (H. S dhe N. A), kishin kaluar njëri pas tjetrit në Prokurorinë Speciale, për të kaluar lënda më pas te prokurori R. H.

57 Rasti numër PKR. nr. 37/18 në **GjTh në Gjakovë** të cilin rast ka përfaqësuar prokurori Agron Metjani ndërsa atë e kishte zëvendësuar prokurori nga Departamenti për të Mitur Xhavit Osmani dhe i cili, gjatë përfaqësimit bazuar në monitorim, kishte treguar performancë të dobët.



Papërgatitja e prokurorëve për përfaqësimin e aktakuzave, mangësitë profesionale si dhe përfaqësimi i dobët i prokurorisë për arsyet e ndryshme, vazhdon t'i kushtojë sistemit të drejtësisë me mungesë efikasiteti dhe rezultate të dobëta në luftimin e korrupsionit dhe të krimit të organizuar.

Raste të tjera të ndërrimit të prokurorëve gjatë përfaqësimit të aktakuzave janë identifikuar edhe në GjTh në Mitrovicë,⁵⁸ Prizren⁵⁹ dhe Gjakovë.⁶⁰

Duke u bazuar në gjetjet e Organizatës Çohu!, ndërrimi i prokurorëve kishte ndodhur për arsye të ndryshme. Derisa disa nga arsyet kishin qenë për shkak të numrit të vogël të prokurorëve, arsye të tjera kishin të bënin edhe me lëvizjen e prokurorëve në nivelet e tjera, apo edhe për shkak të pensionimit të tyre.

Papërgatitja e prokurorëve për përfaqësimin e aktakuzave, mangësitë profesionale si dhe përfaqësimi i dobët i prokurorisë për arsyet e ndryshme, vazhdon t'i kushtojë sistemit të drejtësisë me mungesë efikasiteti dhe rezultate të dobëta në luftimin e korrupsionit dhe të krimit të organizuar.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, përkatësisht mekanizmat disiplinorë dhe të performancës së KPK-së, vazhdojnë të ketë mungesë të rezultateve në ndëshkimin dhe disiplinimin e prokurorëve të cilët kanë rënë ndesh me rregullat etike, profesionale dhe ligjore. Përkundër performancës së dobët të prokurorisë, përkundër dështim-

it të tyre në argumentimin dhe mbështetjen e akuzave dhe dështimit të aktakuzave, të rralla mbeten rastet e inicimit të procedurave disiplinore dhe ndëshkuese ndaj prokurorëve të cilët kanë pasur performancë të dobët dhe kanë dështuar me aktakuzat e tyre.

1.8 Ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues

Ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues vazhdon të shkaktojë zvarritjen e proceseve gjyqësore si dhe grumbullimin e lëndëve, pavarësisht rritjes së numrit të gjykatësve krahasuar me vitet e kaluara. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, konkretisht Neni 311 parasheh se në rastet kur përbërja e trupit gjykues ka ndryshuar, shqyrtimi gjyqësor i shtyrë fillon rishtas. Por, në rastin e tillë, trupi gjykues pas dëgjimit të palëve mund të vendosë që dëshmitarët dhe ekspertët të mos merren sërish në pyetje dhe të mos bëhet këqyrja e re e vendit, por të lexohen deklaratimet e dëshmitarëve dhe ekspertëve të dhëna në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor apo të lexohet procesverbali i këqyrjes së vendit.⁶¹

58 Shënim: Rasti i shënjestruar për liberalizim të vizave P.nr. 147/17 i cili ka të bëjë me krim të organizuar, ka kaluar tek prokurori Atdhe Dema ngase përpiluesi i saj prokurori Abdurrahim Islami, kishte arritur moshën e pensionimit. Rasti me numër PKR.nr. 14/19 në **GjTh në Gjakovë**, përpilues i aktakuzës është prokurori RamizBuzhala mirëpo atë e kishte zëvendësuar Ali Uka ngase përpiluesi i saj ishte në pushim vjetor.

59 Shënim: Në rastin PKR.nr.211/16 në **GjTh në Prizren**, Prokurori Mehdi Sefa ka përfaqësuar 2 here ndërsa prokurori Genc Nixha 2 herë. Rasti tjetër është rasti PKR.nr.79/18 në GjTh në Prizren, Prokurori Mehdi Sefa ka përfaqësuar 4 here ndërsa prokurori MetushBiraj herë.

60 Shënim: Në rastin PKR.nr.36/18 në **GjTh në Gjakovë**, Prokurori Agron Matjani ka përfaqësuar 4 here ndërsa prokurori Ramiz Buzhala 2 herë. Në rastin tjetër PKR.nr.50/18 në GjTh në Gjakovë, Prokurori Ali Uka ka përfaqësuar 3 here ndërsa prokurori Agron Matjani 1 herë.


61 Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, par.1 i nenit 311; <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>

Organizata Çohu! gjatë monitorimit ka hasur në një numër rastesh të ndryshimit të trupit gjykues në gjykatën themelore në Prishtinë⁶².

Arsyet kryesore të ndryshimit të trupit gjykues ishin angazhimet e gjykatësve në raste të tjera dhe lëvizjet e gjykatësve në nivele të tjera.

Gjykata Themelore e Prishtinës vazhdon të jetë gjykata me më së shumti probleme sa i përket kompletimit të trupit gjykues. Në rastin e njohur “Stenta 2”, rast ky i shënjestuar dhe i cili do duhej të trajtohej me prioritet, përbërja e trupit gjykues ka pësuar ndryshime dy herë nga ajo fillestare. Pamundësia e kompletimit të trupit gjykues kishte ardhur për shkak të angazhimeve të njërit anëtar të trupit gjykues në raste të tjera në kohën kur ishte paraparë zhvillimi i seancës.⁶³

Përkundër rritjes së numrit të gjykatësve krahasuar me vitet e kaluara, GjTh në Prishtinë vazhdon të përballet me ndryshim apo zëvendësim të njërit anëtar të trupit gjykues, gjë e cila po shkakton zvarritjen e procesit gjyqësor dhe njëkohësisht mohim të të drejtave të njeriut – siç është e drejta për gjykim të drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme.



Përkundër rritjes së numrit të gjykatësve krahasuar me vitet e kaluara, GjTh në Prishtinë vazhdon të përballet me ndryshim apo zëvendësim të njërit anëtar të trupit gjykues, gjë e cila po shkakton zvarritjen e procesit gjyqësor dhe njëkohësisht mohim të të drejtave të njeriut – siç është e drejta për gjykim të drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme.

62 Shënim: Rasti PKR.nr. 298/18, në seancën e monitoruar me dt. 28 mars 2019 në GJykatën Themelore të Prishtinës, trupi gjykues ka pësuar ndryshim për këtë arsye shqyrtimi gjyqësor filloi rishtazi.

Rasti PKR.nr. 314/16, në seancën e monitoruar me dt. 21 shkurt 2019 në GJykatën Themelore të Prishtinës, trupi gjykues ka pësuar ndryshim për këtë arsye shqyrtimi gjyqësor filloi rishtazi.

Rasti PKR.nr. 610/16, në seancën e monitoruar me dt. 16 maj 2019 në GJykatën Themelore të Prishtinës, trupi gjykues ka pësuar ndryshim për këtë arsye shqyrtimi gjyqësor filloi rishtazi.

Rasti PKR.nr. 1113/13, në seancën e monitoruar me dt. 27 maj 2019, në GjTh në Prishtinë, trupi gjykues ka pësuar ndryshim për këtë arsye shqyrtimi gjyqësor filloi rishtazi.

Rasti PKR.nr. 110/17, në seancën e monitoruar me dt. 31 maj 2019, në GjTh në Prishtinë, trupi gjykues ka pësuar ndryshim për këtë arsye shqyrtimi gjyqësor filloi rishtazi.

Rasti PKR.nr. 204/18, në seancën e monitoruar me dt. 10 qeshor 2019, në GjTh në Prishtinë, trupi gjykues ka pësuar ndryshim për këtë arsye shqyrtimi gjyqësor filloi rishtazi.

Rasti PKR.nr. 206/18, në seancën e monitoruar me dt. 10 korrik 2019, në GjTh në Prishtinë, trupi gjykues ka pësuar ndryshim për këtë arsye shqyrtimi gjyqësor filloi rishtazi.

Rasti PKR.nr. 610/16, në seancën e monitoruar me dt. 5 shtator 2019, në GjTh në Prishtinë, trupi gjykues ka pësuar ndryshim për këtë arsye shqyrtimi gjyqësor filloi rishtazi.

63 Shënim: Rasti me numër të lëndës PKR.nr. 40/18 i njohur si rasti “Stenta”, i monitoruar me datë 31 janar 2019 në GJykatën Themelore të Prishtinës. Trupi gjykues në këtë çështje penale kishte pësuar ndryshim për shkak se njëri nga anëtarët e trupit gjykues kishte qenë i angazhuar në një seancë tjetër gjyqësore. Rasti i njëjtë, i monitoruar me datë 1 prill 2019 në GJykatën Themelore të Prishtinës. Trupi gjykues në këtë çështje penale prapë ka pësuar ndryshim për këtë arsye shqyrtimi gjyqësor filloi rishtazi.

2. RASTET E PROFILIT TË LARTË - LUFTIMI I KORRUPSIONIT TË NIVELIT TË LARTË

Gjatë monitorimit të gjykatave Organizata Çohu! si prioritet ka pasur monitorimin e rasteve të cilat konsiderohen të profilin të lartë. Duke e bazuar në Ligjin për Prokurorin e Shtetit, Prokurori i Shtetit me pajtimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Kosovës dhe me Kryeprokuroren e EULEX-it atëkohë, më 13 nëntor të vitit 2013 kishin nxjerrë Udhëzimin Administrativ i cili bënte kualifikimin e korrupsionit të nivelit të lartë.⁶⁴

Sipas udhëzimit administrativ, niveli i lartë i korrupsionit konsiderohen të gjitha rastet në të cilat janë të përfshirë: Presidenti i Kosovës, Kryetari i Kuvendit dhe deputetët, Kryeministri, zv/kryeministri/at dhe ministrat e Qeverisë së Kosovës, kryetarët e komunave, gjykatësit e Gjykatës Supreme dhe gjykatësit e Apelit, Kryeprokurori i Shtetit dhe kryeprokurorët.

Me qëllim **të intensifikimit të punës së gjykatave dhe arritjes së rezultateve të duhura, ligji i ri për Gjykatat në Republikën e Kosovës, në janar të vitit 2019 kishte**

paraparë themelimin e Departamentit Special pranë Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit. Sipas ligjit, Departamenti Special në kuadër të GjTh në Prishtinë ka kompetencë të shqyrtojë lëndët të cilat bien në kompetencë të PSRK-së, lëndë këto që kanë të bëjnë me veprat penale të korrupsionit, krimit të organizuar, shpëlarjen e parave dhe terrorizmit. Të gjitha çështjet pranë Departamentit Special do të gjykohen nga trupi gjykues prej tre (3) gjyqtarëve profesionistë, nga të cilët njëri duhet të jetë kryesues i trupit gjykues.⁶⁵

Themelimi i Departamentit Special pranë GjTh në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit ishte paraparë me hyrjen në fuqi të ligjit për gjykata, i cili ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2019. Mirëpo, ky departament i cili **është** themeluar me qëllim të ngritjes së efikasitetit në trajtimin e lëndëve të cilat bien në kompetencë të Prokurorisë Speciale, është funksionalizuar me vonesë, konkretisht më 8 korrik të vitit 2019.

64 Udhëzimi Administrativ për Korrupsionin e Nivelit të Lartë, 13 nëntor 2013, Prishtinë.

65 LIGJI Nr. 06/L - 054 PËR GJYKATAT: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18302>

Ish-ministri Ferid Agani dhe ish-sekretari i Ministrisë së Shëndetësisë Gani Shabani, sipas aktakuzës së PSKR-së të njëjtit kishin kryer veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, me ç'rast kishin dëmtuar buxhetin e Kosovës në shumë prej



4,555,553 euro.

Sipas të dhënave të monitorimit, në shtatë gjykatat themelore (Gjakovë, Prizren, Pejë, Ferizaj Prishtinë, Gjilan dhe Mitrovicë), janë identifikuar vetëm **17 raste**⁶⁶ të korrupsionit të nivelit të lartë në të cilat janë të përfshirë deputetë, ministra, kryetarë të komunave dhe gjykatës të apelit.

Organizata Çohu! vlerëson se dënimet e ulëta, hedhja poshtë e aktakuzave dhe lirimi i zyrtarëve të kualifikuar si zyrtarë të profilin të lartë, flet për shkallën e ulët të luftimit dhe ndëshkimit të korrupsionit të nivelit të lartë. Hedhja poshtë e aktakuzave dhe lirimi i të akuzuarve mund të shihet si mungesë e profesionalizmit të prokurorisë me rastin e ngritjes së aktakuzave dhe pamundësi e tyre të provimit të fakteve për të cilat prokuroria ka pretenduar fajësinë e zyrtarëve të lartë publik të përfshirë në hetimet e tyre.

Ish-ministri Ferid Agani dhe ish-sekretari i Ministrisë së Shëndetësisë Gani Shabani, sipas aktakuzës së PSKR-së të njëjtit kishin kryer veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, me ç'rast kishin dëmtuar buxhetin e Kosovës në shumë prej 4,555,553 euro. Për këtë, nga gjykata e shkallës së parë, ish-ministri Agani ishte dënuar me 2 vjet e 6 muaj burgim efektiv ndërsa ish-sekretari Shabani ishte dënuar me 6 muaj burgim efektiv.⁶⁷

Rasti i njohur si "FAN" ku të akuzuar ishin Naser Osmani, ish-deputet i LDK-së si nënkryetar i Bordit të Drejtorëve të AKP-së, Bahri Shabani si drejtori i Bordit të AKP-së, Shkelzen Llluka si menaxher i AKP-së, Naim Avdiu si zv/drejtor menaxhues i AKP-së dhe Melita Ymeraga, Ardian Kelmendi, si kryesues të Njësisë së Monitorimit në AKP në bashkëpunim me zyrtarët e tjerë si anëtarë ndërkombëtarë të AKP-së: Lisa Brodey, Mohammed Omran dhe

66 Shënim: **GjTh në Prishtinë**, rasti me numër të lëndës PKR.nr. 734/15 (i akuzuar N.O ish deputet i LDK-së, në cilësinë e nënkryetarit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së B.Sh si drejtori i Bordit të AKP-së, Shkelzen Llluka si menaxher i AKP-së, N.A si zv/drejtor menaxhues i AKP-së dhe M.Y, A. K, si kryesues të Njësisë së Monitorimit në AKP në bashkëpunim me zyrtarët e tjerë si anëtarë ndërkombëtarë të AKP-së L.B, M.O, H.E), PKR.nr. 230/18 (të akuzuar A.Ç, Sh.D, Sh.B, Rr.B, në cilësinë e ish-deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës), rasti Pronto, me nr. të lëndës PKR.nr. 90/18 (të akuzuar, A.G ish-shëf i grupit parlamentar të PDK-së, B.B ministër i Inovacionit dhe ndërmarrësisë, Z.K ish-deputet i PDK-së, PKR.nr. 369/16 (të akuzuar F.A, ish- ministër i Shëndetësisë dhe G.Sh ish-Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë), PKR.nr. 242/18 (i akuzuar N.D, në cilësinë e kryetarit të Komunes së Drenasit), PKR.nr. 610/16 (i akuzuar A.S, në cilësinë e ish-deputetit të PDK-së), PKR.nr.53/17 (i akuzuar Sh.B, në cilësinë e kryetarit të Komunes së Lipjanit), PKR.nr.18/15 (i akuzuar S.L, në cilësinë e ish-kryetarit të Komunes së Skenderaj).

GjTh në Gjilan, rasti me numër të lëndës PKR.nr. 189/17 (i akuzuar R.M, në cilësinë e ish-kryetarit të Komunes së Prizrenit), PKR.nr. 3/17 (i akuzuar S.M, në cilësinë e kryetarit të Komunes së Kllokotit).

GjTh në Gjakovë, rasti me nr. të lëndës PKR.nr. 16/18 (i akuzuar P.L, ish-kryetarit të Komunes së Gjakovës dhe ish-minister i infrastrukturës).

GjTh në Pejë, rasti PKR.nr.168/16 (i akuzuar S.B, ish kryetar i Komunes së Gjakovës), PKR.nr.25/18 (i akuzuar H.R , kryetar i Istogut), PKR.nr. 227/16 (i akuzuar Q.M, ish kryetar i Komunes së Gjilanit).

GjTh në Prizren, PKR.nr. 91/18 (i akuzuar B.N, ish-zëvendësministër), PKR.nr. 87/18 (i akuzuar S.A, ish-kryetar i Komunes së Suharekës), PKR.nr. 10/18 (i akuzuar S.J, ish kryetar i Komunes së Dragashit).

67 Shpallja e aktgjykimit në rastin e njohur "Stenta 1", është bërë me 24 prill 2019.

Hubert Ersmann, të njëjtit sipas aktakuzës së PSRK-së i kanë kaluar kompetencat zyrtare me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë për vete ose për personin tjetër, në vlerë prej 5,400,000 euro, gjykata e shkallës së parë të i ka shpallur të pafajshëm.⁶⁸

Dënimet e ulëta për zyrtaret e profilin të lartë përkundër shpalljes fajtor për shumatat e mëdha të përfitimit apo dëmtimit të buxhetit publik, përveçse nuk ndëshkojnë keqpërdoruesit e pozitive publike, bartin edhe mesazhin negativ për keqpërdoruesit potencialë.

2.1 Mungesa e të dhënave për profilet e larta

Sipas të dhënave të KGJK-së, në pesë vitet e fundit gjykatat themelore në Kosovë me degët përkatëse kishin në punë gjithsej 1998 raste të natyrës së korrupsionit, pa specifikuar se sa nga këto i përkasin korrupsionit të nivelit të lartë sipas Udhëzimit të Prokurorisë Speciale.

Gjatë monitorimit njëvjeçar, Çohu! kishte monitoruar 242 raste me 575 seanca në GjTh në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Ferizaj, Gjiilan, Prizren, Gjakovë. Gjatë monitorimit janë identifikuar gjithsej 17 raste të profilin të lartë.

Përkundër kërkesës, KGJK, nuk ka ofruar të dhëna sa i përket numrit të lëndëve të korrupsionit të nivelit të lartë për 5 vitet e fundit. Po ashtu, KGJK nuk është përgjigjur fare lidhur me numrin e lëndëve të korrupsionit të nivelit të lartë sipas Udhëzimit të lartpërmendur për 5 vitet e fundit e as për vitin e fundit në gjykatat themelore të Kosovës, por as për numrin total të lëndëve të natyrës korruptive në këto gjykata.

Në përgjigjen e datës 23 nëntor 2018, Zyra për Statistika e KGJK-së është përgjigjur se ajo ka ndërmarrë veprime konkrete për hartimin e planit për zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit dhe ka formuar komisionin për implementimin e këtij plani, i cili sipas zyrtarëve të tij është mjaft

i suksesshëm në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit si dhe në mënyrën e zgjidhjes së tyre.

Sipas KGJK-së lëndët e korrupsionit trajtohen me prioritet të lartë dhe këtu nuk ka ndonjë dallim mes lëndëve të korrupsionit dhe ato të nivelit të lartë, por për lëndët e nivelit të lartë është bërë databazë e veçantë ku janë të përfshira 45 raste. Tutje, në përgjigjen e tyre thuhet se kategorizim të rasteve të profilin të lartë nuk ka pasi që komisioni përcjell dinamikën e të gjitha lëndëve që hynë në kapitullin e veprave penale të korrupsionit, kurse lëndët e profilin të lartë janë lëndët e shënjestruara, nuk ka as profilizim të gjyqtarëve, dhe të gjitha lëndët e korrupsionit janë në kompetencë lëndore të departamentit për krime të rënda të gjykatave themelore.

Organizata Çohu! konsideron se mungesa e të dhënave të kategorizuara sipas profilin të njerëzve të përfshirë në aktakuza dhe procese gjyqësore pamundëson ofrimin e një pasqyre të plotë dhe pasqyrimin e duhur për të evidentuar se cilat institucione dhe pozita të autoritetit publik janë më të përfshira në rastet e korrupsionit.

Pasqyrimi i plotë i kësaj problematike dhe të dhënat e plota për profilin dhe pozitat e personave të përfshirë në rastet e hetuara dhe të gjykuara të korrupsionit do të mundësonte pasqyrim të plotë të institucioneve dhe të pozitive me autoritet publik që janë të përfshira më shumë në rastet e natyrës korruptive. Mungesa e një pasqyre të tillë vëshitrëson gjithashtu krijimin dhe zbatimin e strategjisë së luftimit dhe trajtimit më efikas të rasteve të tilla ndaj institucioneve dhe autoriteteve të tilla publike.

Prandaj konsiderojmë se kategorizimi i të dhënave të tilla sipas profilin dhe pozitës së të akuzuarve është me rëndësi për sistemin e drejtësisë, për evidentimin dhe pasqyrimin e plotë të rasteve të tilla e që do t'i kontribuonte gjithashtu transparencës së sistemit të drejtësisë.

68 Shpallja e aktgjykimin në rastin e njohur "FAN", është bërë me 8 shkurt 2019.



3. PERFORMANCA E PROKURORËVE DHE GJYKATËSVE NË PROCEDIMIN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE

Organizata Çohu! gjatë monitorimit në fokus ka pasur edhe monitorimin e vlerësimit të performancës së gjykatësve dhe prokurorëve.

Organet kompetente në Republikën e Kosovës kanë ndër-marrë një sërë hapash për reformimin dhe përmirësimin e sistemit të drejtësisë në përgjithësi. E gjithë kjo është bërë me qëllim që drejtësia të ofrohet në kohë të arsyeshme dhe qytetarët të kenë qasje të barabartë në drejtësi. Por, me gjithë përpjekjet dhe reformat e ndërmarra, në prokurori dhe gjykata ende ka mungesë të efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve, qytetarët vazhdojnë të ballafaqohen me zvarritje të proceseve gjyqësore si dhe ka drejtësi joefikase.

Për vlerësim të performancës së prokurorëve dhe gjyqtarëve janë krijuar komisione të posaçme, mirëpo këto organe nuk kanë dhënë rezultate të cilat do të pasqyronin punë më efikase të gjykatave dhe prokurorive. Megjithëse kemi një numër të konsiderueshëm të lëndëve të parash-

kruara në njërin anë dhe një numër të madh të lëndëve të cilat po barten nga viti në vit në anën tjetër, për fajin edhe të gjykatësve dhe prokurorëve organet kompetente për vlerësim të performancës së prokurorëve dhe gjykatësve nuk kanë marrë ndonjë masë ndëshkuese evidente ndaj prokurorëve dhe gjykatësve të cilët kanë treguar mungesë profesionalizmi në trajtimin e lëndëve – me theks të veçantë në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

3.1 Institucionet për vlerësimin e performancës

Sipas legjislacionit të Kosovës janë dy organe të cilat bëjnë vlerësimin e performancës së gjyqtareve dhe prokurorëve dhe të cilat përkujdesen për mbështetje të organeve që administrojnë me gjykata dhe prokurori: Komisionet për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve dhe Gjyqtareve

dhe Njësitet për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive dhe Gjykatave.⁶⁹

Gjatë vitit 2017, Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve (KVPP) ka mbajtur 25 takime pune, ka realizuar 14 vizita pune nëpër prokurori dhe ka finalizuar shtatë (7) procese (1 nga viti 2016 dhe 6 sipas planit të veprimit për vitin 2017) të vlerësimit të performancës përmes së cilave është bërë vlerësimi i Raportit Vjetor 2017.

Me qëllim të realizimit të punës së tij, Komisioni ka hartuar planin e veprimit për vitin 2018 në të cilin janë planifikuar 5 procese për vlerësimin e performancës në të cilën janë përfshirë gjithsej 67 prokurorë, prej të cilëve 33 prokurorë me mandat të përhershëm, 12 prokurorë me mandat fillestar (vlerësimi i dytë) dhe 22 prokurorë me mandat fillestar (vlerësimi i parë). Megjithatë, ky komision ka arritur të tejkalojë planifikimin e tij me ç'rast ka vlerësuar 81 prokurorë (me mandat fillestar dhe të përhershëm)⁷⁰.

Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive, duke u mbështetur në kompetencat ligjore, gjatë vitit 2017 ka realizuar mbështetjen për Këshillin në proceset si mbikëqyrja dhe raportimi mbi punën e prokurorive, vlerësimi i performancës së prokurorëve, administrimi i prokurorive, rekrutimi, transferimi dhe avancimi i prokurorëve, vlerësimi i nevojave për trajnim të prokurorëve dhe mbajtja e shënimeve dhe bazave të dhënave për punën e prokurorive.⁷¹

Sa i përket vlerësimit të performancës së gjyqtarëve për vitin 2017 janë monitoruar 66 gjyqtarë, ku 2 prej tyre kanë qenë me mandat fillestar, 54 me mandat të përhershëm, të përzgjedhur sipas metodës së rastësishme, dhe 10 gjyqtarë që janë kandidatë për ngritje në detyrë. Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve ka mbajtur rreth 30 takime. Anëtarët raportues të Komisionit kanë monitoruar 66 gjyqtarët që kanë qenë pjesë e procesit të

vlerësimit të performancës, dhe gjithashtu kanë realizuar intervista me gjyqtarët që kanë qenë subjekt i vlerësimit.⁷²

3.2 Metodologjia e vlerësimit të performancës së prokurorëve dhe gjykatësve

Vlerësimi i performancës së prokurorëve bëhet në bazë të takimeve të kryeprokurorëve të Prokurorive në takimet mujore me Kryeprokurorin e Shtetit, të cilët raportojnë për rrjedhën e punës gjatë asaj periudhe dhe për numrin e lëndëve në punë dhe atyre të zgjidhura. Po ashtu, në baza tremujore i dërgojnë raport me shkrim KPK-së për çështjet që ndërlidhen me administrimin e prokurorisë.

KPK harton raporte analitike periodike dhe vjetore për punën e Prokurorit të Shtetit, ku ofrohen informacione të përgjithshme për Prokurorin e Shtetit, duke përfshirë numrin e prokurorëve. Në ato raporte pasqyrohen kallëzimet – lëndët penale të trashëguara, të pranuar në punë dhe ato të kryera nga ana e prokurorëve në të gjitha nivelet e sistemit prokurorial, departamentet përkatëse të prokurorive duke përfshirë edhe parashtuesit e këtyre kallëzimeve si dhe të dhëna statistikore me anë të të cilave pasqyrohet efikasiteti në punë për secilën prokurori. Gjithashtu hartohen raportet periodike dhe vjetore të mekanizmit përcjellës ku përfshihen veprat penale të kategorizuara në 9 grupe.⁷³

Komisioni i cili bën vlerësimin e performancës së gjyqtarëve përbëhet nga 13 anëtarë. Përbërja e Komisionit përfaqëson shkallshmerinë e sistemit gjyqësor asisoji që nga Gjykata Supreme caktohen 5 gjyqtarë, nga Gjykata e Apelit caktohen 4 gjyqtarë dhe nga radhët e gjykatave themelore caktohen 3 gjyqtarë. Gjyqtarët e caktuar në Komision duhet të kenë se paku 5 vite përvojë pune si gjyqtar nga lëmi civil dhe penal.

69 Ligji nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial dhe ligji nr 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor

70 Raporti Vjetor 2017 i Këshillit Prokurorial të Kosovës:

[http://www.kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Statistika%20dhe%20Raporte/Raporte%20Vjetore/Raporti%20vjetor%20i%20Pun%C3%ABs%202017%20i%20K%C3%ABshillit%20Prokurorial%20t%C3%AB%20Kosov%C3%ABs\(1\).pdf](http://www.kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Statistika%20dhe%20Raporte/Raporte%20Vjetore/Raporti%20vjetor%20i%20Pun%C3%ABs%202017%20i%20K%C3%ABshillit%20Prokurorial%20t%C3%AB%20Kosov%C3%ABs(1).pdf)

71 [http://www.kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Statistika%20dhe%20Raporte/Raporte%20Vjetore/Raporti%20vjetor%20i%20Pun%C3%ABs%202017%20i%20K%C3%ABshillit%20Prokurorial%20t%C3%AB%20Kosov%C3%ABs\(1\).pdf](http://www.kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Statistika%20dhe%20Raporte/Raporte%20Vjetore/Raporti%20vjetor%20i%20Pun%C3%ABs%202017%20i%20K%C3%ABshillit%20Prokurorial%20t%C3%AB%20Kosov%C3%ABs(1).pdf)

72 Raporti vjetor 2017 i Këshillit Gjyqësor të Kosovës :file:///C:/Users/Hp/Downloads/Raporti%20Vjetor%20i%20K.GJK-%202017%20(1).pdf

73 Intervistë me Zëdhënësin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, Valon Jupa, me datë 19 Nëntor 2018.

Performanca e gjyqtarëve me mandat të përhershëm vlerësohet çdo tri (3) vjet për secilin gjykatës. Këshilli Gjyqësor çdo fundvit nxjerr vendim për përzgjedhjen e një të tretës së gjyqtarëve për vlerësim, ndërsa për gjyqtarët e rinj, vlerësimi i performancës së gjyqtarëve bëhet dy herë brenda tri viteve.⁷⁴

Duke iu referuar gjithnjë zëdhënësës së KGJK-së, deri më tani komisioni ka vlerësuar 66 gjyqtarë me mandat të përhershëm, 43 gjyqtarë me mandat fillestar dhe 32 gjyqtarë që kanë aplikuar për ngritje në detyrë.

3.3 Raste praktike të dështimit të prokurorëve dhe gjykatësve dhe mungesa e llogaridhënies

Gjatë monitorimit të seancave gjyqësore të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar Organizata Çohu! ka identifikuar raste të dështimit apo të mungesës së profesionalizimit të gjykatësve dhe prokurorëve.

Disa nga rastet e dështimit të gjykatësve dhe prokurorëve janë identifikuar në gjykatat themelore në Prishtinë, Pejë dhe Mitrovicë.

Në GjTh në Prishtinë, me datë 23 prill 2019 ishte paraparë të mbahej fjala përfundimtare mirëpo për shkak të papërgatitjes së prokurores së rastit, fjala përfundimtare ka dështuar të mbahet.⁷⁵

Në GjTh në Pejë, me datë 19 tetor 2018 ishte paraparë të mbahej fjala përfundimtare mirëpo për shkak të papërgatitjes së prokurores së rastit e cila kërkoi kohë shtesë, fjala përfundimtare ka dështuar të mbahet.⁷⁶

Në GjTh në Mitrovicë, në korrik të vitit 2018, Gjykata e Apelit pas ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë e kishte kthyer në rigjykim rastin të cilin gjykatësi i GjTh në Mitrovicë e kishte shpallur të pafajshëm pavarësisht se ai kishte pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohej. Në aktvendimin e Gjykatës së Apelit thuhet se pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se pretendimet e Prokurorisë janë të bazuara dhe se aktgjykimi i atakuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale duke vënë në dyshim edhe gjendjen faktike, ngase konkludimi i gjykatës duke pasur parasysh faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në dyshim edhe gjendjen e fakteve dhe absolutisht nuk mund të konsiderohet i drejtë. Rastin e lartpërmendur Organizata Çohu! e ka monitoruar pasi që ai është kthyer në rigjykim.⁷⁷

Në GjTh në Prishtinë, më 29 janar 2019 ishte paraparë të bëhej shpallja e aktgjykimit, mirëpo trupi gjykues vendosi që shpallja e aktgjykimit të bëhej një ditë tjetër për shkak se trupi gjykues nuk kishte arritur t'i shqyrtonte të gjitha shkresat e lëndës.⁷⁸

Pavarësisht rasteve të dështimit të prokurorëve dhe gjykatësve, organet përkatëse nuk kanë ndërmarrë asnjë masë llogaridhënëse dhe ndëshkuese ndaj gjykatësve apo prokurorëve për shkak të mungesës së profesionalizimit të tyre në zgjidhjen e rasteve. Mungesa e inicimit të rasteve, mungesa e ndëshkimeve dhe llogaridhënies ka vënë në pah pasivitetin e komisioneve për vlerësimin e performancës së prokurorëve dhe gjykatësve, të cilat kanë vazhduar të mos jenë në nivelin e përgjegjësisë të përcaktuara edhe me dispozitat ligjore dhe procedurale. Si pasojë e kësaj, qytetarët vazhdimisht ballafaqohen me drejtësi jo-efikase dhe shkelje të të drejtave të njeriut.

74 Intervistë me Zyrtaren për Informim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Aishe Qorraj, datë 19 nëntor 2018.

75 GjTh në Prishtinë, Rasti PKR.nr. 18/15 e monitoruara me dt. 23 prill 2019, veprat penale "Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar", "mashttrim" etj. Aktakuzën në këtë rast e përfaqësonte prokurorja Florije Shamolli.

76 GjTh në Pejë, Rasti 168/16 e monitoruar me dt. 19 tetor 2018, vepra penale "Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar". Aktakuzën në këtë rast e përfaqësonte prokurorja Sahide Gashi.

77 Shënim: GjTh në Mitrovicë, P.nr. 125/18, gjykatësi Tomislav Petrovic e kishte shpallur të pafajshëm të pandehurin N.A pavarësisht se i njëjti kishte pranuar fajësinë për veprën penale "Keqpërdorimi i detyrës apo autoritetit zyrtar". Rasti pasi që kthyer në rigjykim është monitoruar me datë 25 janar 2019.

78 GjTh në Prishtinë, Rasti PKR.nr. 734/15, vepra penale "Keqpërdorimi i detyrës apo autoritetit zyrtar".

4. DREJTËSIA NË MITROVICË



4.1 Prokuroria dhe Gjykata në Mitrovicë

Gjykata Themelore në Mitrovicë është njëra prej shtatë gjykatave themelore në Republikën e Kosovës e cila brenda juridiksionit të saj ka katër degë: Leposaviq, Vushtrri, Sken-deraj, dhe Zubin Potok, territor që mbulon 328 fshatra.⁷⁹

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka në juridiksion të gjitha lëndët e shkallës së parë përveç nëse me ligj parashihet ndryshe. Ajo përbëhet nga Departamenti i Përgjithshëm, Departamenti i Krimeve të Rënda si dhe Departamenti për të Mitur. PTh në Mitrovicë mbulon territorin e Mitrovicës, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Skenderajit dhe Vushtrrisë.

Nga tetori i vitit 2017, Drejtësia në Mitrovicë funksionon sipas Marrëveshjes së Brukselit për Drejtësinë. Kjo marrëveshje ka paraparë që Kryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë të jetë nga komuniteti serb ndërsa administratori i Gjykatës si dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Mitrovicës të jenë shqiptarë, gjë e cila është respektuar dhe zbatuar me përpikëri.⁸⁰

Sipas po kësaj Marrëveshjeje, GjTh në Mitrovicë do ta ketë edhe divizionin e Gjykatës së Apelit, e cila do të jetë kompetente vetëm për lëndët e kësaj gjykate me degët e saj. Marrëveshja e tillë përveç tjerash kishte përcaktuar gjithashtu numrin dhe përkatësinë etnike të prokurorëve dhe gjykatësve, gjë e cila edhe kishte ngritur kritika për shkelje të dispozitave kushtetuese dhe ligjore.⁸¹ Sidoqoftë, krijimi i këtij divizioni bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet e tjera përkatëse duke krijuar kështu një rast të pashembullt dhe që edhe mund të rrezikojë funksionimin e këtij divizioni dhe të kësaj gjykate si të shkëputur nga gjyqësori i Kosovës.⁸²

4.2 Struktura organizative e Prokurorisë dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë sipas Marrëveshjes së Brukselit

Prokuroria Themelore në Mitrovicë në muajin tetor të vitit 2017 ishte bartur me seli në veri të Mitrovicës, përkatësisht në “Lagjen e Boshnjakëve”, duke u bazuar në

79 Këshilli Gjyqësor i Kosovës - <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/courts/page/index/198>.

80 Marrëveshja e Brukselit për Drejtësinë, e arritur ndërmjet palës Kosovare dhe asaj Serbe, 9 shkurt 2015, Bruksel.

81 Ibid.

82 “Goingsouth? Integration of Serb Judges and Prosecutors from the North into the Kosovar Justice System”, November 2018, Grupi për Studime Juridike dhe Politike, <http://www.legalpoliticalstudies.org/ep-content/uploads/2018/11/FINAL-REPORT-Integration.pdf>

Marrëveshjen e Brukselit për Drejtësinë.⁸³ Pika e marrëveshjes e cila përcakton përbërjen e Prokurorisë me shqiptarë dhe serbë ishte zbatuar në përpikëri me ç'rast stafi i Prokurorisë duhet të kenë përbërje 50% shqiptarë dhe 50% serbë. Po sipas kësaj Marrëveshjeje, PTh në Mitrovicë udhëhiqet nga Kryeprokurori shqiptar, derisa aktualisht prokuroria numëron 9 prokurorë shqiptarë dhe 10 serbë.⁸⁴

Po atë muaj, në tetor të vitit 2017 kishte filluar edhe puna e Prokurorisë Themelore të Mitrovicës sipas Marrëveshjes së Drejtësisë të nënshkruar në Bruksel.

Funksionalizimin sipas Marrëveshjes së Brukselit për Drejtësinë në po këtë kohë e kishte filluar GjTh në Mitrovicë. Duke u bazuar në këtë Marrëveshje, GjTh në Mitrovicë është e ndarë në dy objekte, në veri dhe në jug të Mitrovicës. Objekti në veri, i cili në përbërje ka 15 gjykatës dhe 71 punëtorë të gjykatës – staf mbështetës, është kompetent për trajtimin e çështjeve penale. Ndërsa objekti i vendosur në jug të Mitrovicës dhe i cili numëron 17 gjykatës dhe 71 punëtorë – staf mbështetës, është kompetent për trajtimin e çështjeve civile dhe kundërvajtëse.⁸⁵

GjTh në Mitrovicë aktualisht numëron gjithsej 48 gjykatës ku hyn Gjykata Themelore Mitrovicë – dega Vushtri, Gjykata Themelore Mitrovicë – dega Skenderaj, Gjykata Themelore Mitrovicë – dega Leposaviq, Gjykata Themelore Mitrovicë – dega Zubin Potok⁸⁶

4.3 Ndërprerja e Punës së Gjykatës – nëntor 2018

Rast i paprecedent dhe i cili bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi, ka qenë ndërprerja e punës së Gjykatës Themelore në Mi-

trovicë gjatë nëntorit të vitit 2018. Ndërprerja e punës së Gjykatës ishte bërë me urdhër të kryetarit të GjTh në Mitrovicë, veprim që kishte ardhur në shenjë solidarizimi me qytetarët të cilët protestuan në veri të Mitrovicës për shkak të vendosjes së taksës doganore 100% ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjës e Hercegovinës nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Kryetari i GjTh në Mitrovicë Nikolla Kabashiq u ishte drejtuar me letër ambasadorëve në Kosovë dhe shefave të misionëve ndërkombëtare që duke shfrytëzuar autoritetin e tyre të ndikojnë tek institucionet e Republikës së Kosovës që ta ndryshojnë qëndrimin në lidhje me taksën tashmë të vendosur.

Këto veprime të Kryetarit të GjTh në Mitrovicë bien ndesh me Kushtetutën dhe ligjet pozitive të Republikës së Kosovës si dhe përbëjnë shkelje të Marrëveshjes për Drejtësinë të nënshkruar në Bruksel.

Sipas legjislacionit në fuqi, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre gjyqtarët duhet të jenë të pavarur, të paanshëm dhe të pandikuar. Duke u bazuar në këtë, çfarëdo lidhje apo ndikim politik përbën shkelje të integritetit dhe pavarësisë së gjyqësorit në Republikën e Kosovës.

Në anën tjetër për një veprim të tillë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ishte mjaftuar vetëm me një vërejtje për kryetarin e Gjykatës, duke mos i konsideruar shkelje serioze veprimet e tilla të kryetarit të GjTh në Mitrovicë, Nikolla Kabashiq.⁸⁷

Ndërmarrja e masave eventuale serioze ndaj përgjegjësve dhe në këtë rast ndaj Nikola Kabashiq, përveç tjerash do të siguronte dhe garantonte funksionimin e GjTh në Mitrovicë pa asnjë lloj ndikimi politik, në përputhje me Rendin Kushtetues dhe Juridik të Kosovës.

83 Marrëveshja e Brukselit për Drejtësinë, e arritur ndërmjet palës Kosovare dhe asaj Serbe, 9 shkurt 2015, Bruksel.

84 Intervistë me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ShyqriSyla, intervistuar me datë 22 Nëntor 2018, Mitrovicë.

85 Intervistë me nënkryetarin e GjTh në Mitrovicë AliKutlllovci, intervistuar në nëntor të vitit 2018.

86 Nënkryetari i GjTh në Mitrovicë AliKutlllovci, gjatë intervistës deklaroi se, rezultoi se numri i paraparë sipas Marrëveshjes së Drejtësisë për gjykatës shqiptar ende nuk është plotësuar.

87 Shënim: Organizata ÇOHU, ka pranuar një shkresë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në të cilën shihet se i është tërhequr vërejtja që një veprim i tillë bie ndesh me Kodin e Etikës për Gjyqtar, në veçanti me dispozitat e Seksionit 2.

Numri i prokurorëve në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë

Viti	Numri i prokurorëve
2004	9 
2008	10 
2013	10 
2018	20 

TABELA NR. 1 Numri i prokurorëve në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, nëpër vite.

4.4 Numri i prokurorëve dhe gjykatësve si dhe procedimi me lëndët

PTh në Mitrovicë ashtu si i gjithë sistemi prokurorial për vite me radhë është ballafaquar me mungesë të numrit të mjaftueshëm të prokurorëve. Sipas të dhënave të KPK-së, në vitin 2004 PTh në Mitrovicë kishte gjithsej 9 prokurorë, ndërsa në vitin 2018 numri i prokurorëve në këtë prokurori kishte arritur në 20 të tillë.

Duke u bazuar në të dhënat e PTh në Mitrovicë, për një kohë të gjatë kjo prokurori ka pasur numër të vogël të prokurorëve – vetëm 9 dhe 10 prokurorë.

PTh në Mitrovicë me vite të tëra kishte vazhduar punën në kushte të vështira, me mungesë të numrit të nevojshëm me prokurorët dhe gjithashtu, me mungesë të hapësirave të nevojshme për punë. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 2008, gjykatësit dhe prokurorët shqiptarë dhe stafi tjetër ndihmës, nuk kanë pasur qasje në veri të Mitrovicës, ku ndodheshin prokuroria dhe gjykata.⁸⁸ Kjo kishte pamundësuar qasjen e qytetarëve në drejtësi dhe zhvillimin e proceseve gjyqësore duke pamundësuar gjithashtu funksionimin e sistemit prokurorial gjyqësor në këtë pjesë.⁸⁹

Njëjtë si PTh në Mitrovicë, edhe GjTh në Mitrovicë është ballafaquar me problemin e mungesës së gjykatësve si dhe me kushtet e vështira të punës.

⁸⁸ Rapori i OSBE-së lidhur me sistemin gjyqësor në Mitrovicë, janar 2011.

⁸⁹ "Qasja në drejtësi dhe të drejtat e njeriut", Organizata Çohul, korrik 2017 - <http://cohu.org/sq/zyre-antikorrupsion-hulumtime/Qasja-ne-drejttesi-dhe-te-drejtat-e-njeriut-202>.

Numri i gjykatësve në Gjykatën Themelore në Mitrovicë




TABELA NR. 2 Numri i gjykatësve në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, nëpër vite.

Në vitin 2004 regjioni i Mitrovicës numëronte gjithsej 54 gjykatës, ndërsa tani në vitin 2018 Gjykata Themelore e Mitrovicës numëron gjithsej 48 gjykatës.

4.5 Ngarkesa me lëndët dhe efikasiteti

PTh në Mitrovicë kishte hartuar një plan të punës i cili kishte për qëllim zvogëlimin e lëndëve ndërsa si prioritet

kishte lëndët me paraburgim, lëndët e korrupsionit, ato të dhunës në familje si dhe lëndët në të cilat është afruar parashkrimi me qellim të ndërprerjes së tij.⁹⁰

Duke u bazuar në monitorimin dhe hulumtimin e Organizatës Çohu!, nuk është identifikuar efikasiteti i theksuar në trajtim të rasteve nga ana e PTh në Mitrovicë, në veçanti sa u përket rasteve të korrupsionit. Megjithatë, nga viti në vit vërehet trend më pozitiv.

90 Intervistë me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, Shyqri Sylja, intervistuar me datë 22 Nëntor 2018, Mitrovicë

Numri i personave në rastet e proceduara nga PTh në Mitrovicë, sipas viteve

Viti	Të bartura	Të pranuar	Gjithsej në punë	Të zgjidhura				Gjithsej të zgjidhura	Të mbetura
				Hedhura	Pushuara	Të bartura në kompetencë	Aktakuza		
2016	161	91	252 ⁹¹	19	9	1	31	60	192
2017	190	51	241 ⁹²	15	7	3	60	85	156
2018	150	25	175 ⁹³	36	-	3	2	46	129
Totali	501	167	668	70	16	7	93	159	476

TABELA NR. 3. Numri i personave në rastet e proceduara nga PTh në Mitrovicë, sipas viteve 2016 - 2018

Në të dhënat statistikore të KPK-së të pasqyruara në tabelë mund të vërehen rezultate më pozitive të procedimit të rasteve të korrupsionit. Sipas këtyre të dhënave vërehet se gjatë vitit 2016 janë të zgjidhura gjithsej 23 raste me 60 persona, në vitit 2017 janë zgjidhur 29 raste me 85 persona, ndërsa gjatë periudhës (janar – shtator 2018), janë zgjidhur 24 raste me 46 persona të përfshirë në veprat penale të korrupsionit.

Sidoqoftë, sipas përfaqësuesve të kësaj prokurorie arsye e procedimit të pamjaftueshëm dhe mungesës së efikasitetit të theksuar është fakti se Departamenti i Krimeve të Rënda ka funksionuar vetëm me dy prokurorë, ndërsa nga gushti i vitit 2018 i njëjti departament është plotësuar me dy prokurorë të krimeve të rënda më qëllim që procedimit i lëndëve të korrupsionit dhe lëndëve të tjera të jetë më efikas.⁹⁴

Ndryshe nga PTh në Mitrovicë, GjTh në Mitrovicë ende nuk ka plan të punës në bazë të të cilit do të duhej të operonin, duke marrë parasysh kushtet e punës dhe numrin e madh të lëndëve në procedim.

Sipas të dhënave të siguruar nga burimi i njëjtë, gjegjësisht të dhënave nga Mekanizmi Përcjellës për veprat penale karakteristike të sistemit prokurorial, vërehet se vendimet e Gjykatës Themelore në Mitrovicë janë më të pakta në numër, krahasuar nga viti në vit.

91 Shënim: në të dhënat statistikore të KPK-së, në vitit 2016 janë 72 kallëzime penale të bartura ndaj 161 personave, 33 kallëzime ndaj 91 personave të pranuar, gjithsej në punë 105 kallëzime ndaj 252 personave.

92 Shënim: në vitit 2017 janë 79 kallëzime penale të bartura ndaj 190 personave, 35 kallëzime ndaj 51 personave të pranuar, gjithsej në punë 114 kallëzime ndaj 241 personave.

93 Shënim: në periudhën (janar-shtator 2018) janë 82 kallëzime penale të bartura ndaj 150 personave, 22 kallëzime ndaj 51 personave të pranuar, gjithsej në punë 104 kallëzime ndaj 175 personave.

94 Intervistë me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ShyqriSyla, intervistuar me datë 22 Nëntor 2018, Mitrovicë.

Vendimet e Gjykatës Themelore të Mitrovicës ndaj personave për veprat penale të korrupsionit

Viti	Hudhje të aktakuzës	Aktgjykim refuzues	Aktgjykim lirues	Aktgjykim fajësues
2016 ⁹⁵	6	5	2	15
2017 ⁹⁶	1	4	-	5
2018 ⁹⁷	1	1	3	3

TABELA NR. 4. Vendimet e Gjykatës Themelore të Mitrovicës ndaj personave për veprat penale të korrupsionit, sipas viteve 2016 - 2018

Ndërsa në vitin 2016 gjithsej kemi aktgjykime fajësuese ndaj 15 personave për veprat penale të korrupsionit, në vitin 2017 kemi vetëm 5 të tilla, e në nëntëmujorin e parë të vitit 2018 e kemi vetëm një të tillë.

Sipas po këtyre të dhënave, në vitin 2016 ishin hedhur poshtë aktakuzat për 6 persona të natyrës së tillë. Në vitet vijuese, në vitin 2017 dhe në nëntëmujorin e vitit 2018, kemi vetëm nga një aktakuzë të hedhur për veprat penale të natyrës së korrupsionit.

Mungesa e një plani të punës si dhe numri i madh i lëndëve në procedim, vazhdojnë t'i kushtojnë GjTh në Mitrovicë me mungesë efikasiteti dhe me shkelje të afateve procedurale të parapara edhe në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe gjithashtu me parashkrim të rasteve.

4.6 Mungesa e përkthyesve

Sa i përket bashkëpunimit në mes të prokurorëve, gjykatësve dhe stafit në gjykata e prokurori në mes të shqiptarëve dhe serbëve, nuk është hasur ndonjë problem i theksuar dhe sipas vetë përfaqësuesve të sistemit të drejtësisë për këtë pjesë, qëndron një relacion i mire i bashkëpunimit midis tyre si dhe një zbatim i legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës nga ana e komunitetit serb. Gjithsesi, procesi i zhvillimit të mirëfillte të organeve të prokurorisë dhe gjyqësisë do të jetë i varur nga profesionalizmi i tyre dhe zgjidhja efikase e rasteve sipas legjislacionit në fuqi.

Sidoqoftë, PTh në Mitrovicë dhe GjTh në Mitrovicë pas fillimit të implementimit të Marrëveshjes së Brukselit për Drejtësinë kanë hasur në mungesë të përkthyesve shqip-serbisht dhe anasjelltas, e kjo gjë kishte përbërë pengesë të vazhdueshme kundrejt funksionimit të punës së prokurorive dhe gjykatave.

95 KPK, Raporti vjetor (2016) i Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional për harmonizimin e raporteve statistikore, Shkurt 2017, Prishtinë.

96 KPK, Raporti vjetor (2017) i Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional, Shkurt 2018, Prishtinë.

97 KPK, Raporti vjetor (2018) i Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional, Shkurt 2019, Prishtinë.



Prokuroria, edhe Gjykata Themelore në Mitrovicë nga viti 2008 ishte zhvendosur në objektin e ish- Gjykatës Komunale në Vushtrri, me ç'rast për 5 vjet nuk kishin trajtuar fare rastet në gjykatë, ndërsa në prokurori ishin trajtuar vetëm ato të natyrës urgjente.

Derisa prokuroria pothuajse ka tejkaluar problemin e mungesës së përkthyesve duke angazhuar 5 të tillë,⁹⁸ GjTh në Mitrovicë ende vazhdon të ballafaqohet me problemin e tillë.⁹⁹

Sipas vetë përfaqësuesve të gjykatave dhe prokurorive në Mitrovicë, një problem i tillë vazhdon t'i kushtojë sistemit të drejtësisë në këtë pjesë me mungesë të efikasitetit dhe neglizhencë në zgjidhjen e rasteve.¹⁰⁰

Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të duhej që në afatin sa më të shkurtë kohor të ofrojë mbështetje dhe zgjidhje sa i përket përkthyesve në GjTh në Mitrovicë, duke pamundësuar kështu zhvillimin e seancave gjyqësore dhe veprimeve të tjera procedurale të cilat vazhdojnë të zvarrisin zgjidhjen e lëndëve dhe grumbullimin e tyre, duke ndikuar kështu edhe në performancën dhe efikasitetin e gjyqësorit.

4.7 Parashkrimi në Mitrovicë

Parashkrimi apo vjetërsimi i rasteve në prokurori dhe gjykata është ndër problemet e vazhdueshme që karakterizon sistemin e drejtësisë në Kosovë. Arsyet e parashkrimit janë të ndryshme, qoftë për shkaqe dhe pengesa

objektive, qoftë për fajin e prokurorëve dhe gjykatësve, apo si pasojë e neglizhencës dhe veprimit të qëllimshëm. Sipas të dhënave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nga viti **2000 deri në vitin 2017** në gjykatat e Kosovës janë vjetërsuar **20,584 lëndë penale**. Me problemin e njëjtë është ballafaquar edhe Prokuroria dhe Gjykata Themelore në Mitrovicë.

Njëjtë si Prokuroria, edhe Gjykata Themelore në Mitrovicë nga viti 2008 ishte zhvendosur në objektin e ish- Gjykatës Komunale në Vushtrri, me ç'rast për 5 vjet nuk kishin trajtuar fare rastet në gjykatë,¹⁰¹ ndërsa në prokurori ishin trajtuar vetëm ato të natyrës urgjente.

Në pamundësi që lëndët të trajtohen nga ana e prokurorisë, një numër i konsiderueshëm i lëndëve në periudhën 2008–2013 të cilat i takojnë Departamentit të Përgjithshëm janë parashkruar në stacione policore nga ana e prokurorëve.¹⁰²

Në pamundësi që lëndët të barten nga pjesa veriore, një numër i konsiderueshëm i lëndëve të prokurorisë ishin parashkruar, derisa një pjesë e konsiderueshme e lëndëve të parashkruara kishte ardhur për shkak të pamundësisë së trajtimit dhe punës së tyre në kushte të vështira.

98 Intervistë me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, Shyqri Sylja, intervistuar me datë 22 Nëntor 2018, Mitrovicë.

99 Intervistë me Nënkrjetarin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Ali Kutllavci, intervistuar me datë 19 Nëntor 2018, Mitrovicë.

100 Ibid.

101 Shënim: Mbyllja e degëve në Leposaviq dhe Zubin Potok, zhvendosja në objektin e Gjykatës në Vushtrri si dhe pamundësia për të proceduar me rastet në gjykatë për 5 vjet, ka rezultuar me shkeljen e të drejtës për qasje në drejtësi, shkeljen e dispozitave dhe parimeve për një proces të rregullt gjyqësor dhe brenda kohës së arsyeshme si dhe shkeljen e afateve ligjore.

102 Intervistë me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, Shyqri Sylja, intervistuar me datë 22 Nëntor 2018, Mitrovicë.

Për arsye të njëjta, një numër i konsiderueshëm i rasteve janë parashkruar gjithashtu në GjTh në Mitrovicë. Sipas të dhënave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për periudhën 2000 – nëntor 2018, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë me degët në Vushtrri dhe Skenderaj janë parashkruar gjithsej 1,932 lëndë penale, pa të dhënat për degët Zubin Potok dhe Leposaviq.

Sipas hulumtimit të Organizatës Çohu!, Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – US-AID në kuadër të programit për sundimin e ligjit gjatë vitit 2016 kishte filluar inventarizimin, bartjen dhe ndihmën në kategorizimin e lëndëve të cilat kishin mbetur në sirtarët e gjykatave në veriun e Mitrovicës, në Zubin Potok dhe Leposaviq.¹⁰³

Po sipas këtij hulumtimi dhe publikimi, gjatë vitit 2016 nga përfaqësues të USAID-it ishin bartur rreth 1,200 lëndë nga GjTh në Mitrovicë (veri) në objektin në Vushtrri (Gjykata Themelore e Mitrovicës), lëndë këto që nuk ishin proceduar ndër vite. Ndërsa lëndët e bartura nga Leposaviqi dhe Zubin Potoku janë kategorizuar nga stafi i gjykatës dhe janë vendosur me vendim nga gjykatësit e Gj Th në Mitrovicë, të vendosur në Vushtrri, të cilat më pas, janë kthyer si të tilla në Zubin Potok dhe Leposaviq.

Nga gjithsej lëndët e kategorizuara deri në dhjetor të vitit 2016, 1,300 lëndë të tilla janë parashkruar (nga të tre gjykatat, Mitrovicë-Veri, Zubin Potok dhe Leposaviq), mbi 900 lëndë janë mbyllur me vendim ndërsa të tjera kishin qenë në proces. Të gjitha lëndët e tilla i takonin periudhës së para vitit 2008.

Sipas përfaqësuesve të gjykatave në Mitrovicë, bartja e lëndëve dhe epilogu i tyre kishte mundësuar që shumë persona të përfshirë në proceset e tilla dhe të cilët figuronin në evidencat penale, të hiqen nga evidencat dhe të gëzojnë të drejtat e barabarta.¹⁰⁴



Sipas hulumtimit të Organizatës Çohu!, Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID në kuadër të programit për sundimin e ligjit gjatë vitit 2016 kishte filluar inventarizimin, bartjen dhe ndihmën në kategorizimin e lëndëve të cilat kishin mbetur në sirtarët e gjykatave në veriun e Mitrovicës, në Zubin Potok dhe Leposaviq.

103 “Qasja në drejtësi dhe të drejtat e njeriut”, Organizata Çohu!, korrik 2017 - <http://cohu.org/sq/zyre-antikorruption-hulumtime/Qasja-ne-drejttesi-dhe-te-drejtat-e-njeriut-202>.

104 Intervista me nënkryetarin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Ali Kutllovci, atëkohë ushtrues detyre i kryetarit, intervistuar me 3 nëntor 2016, Vushtrri.

PËRFUNDIME

Sistemi i Drejtësisë në Republikën e Kosovës vazhdon të ballafohet me vështirësi sa i përket mbarëvajtjes së proceseve gjyqësore, respektimit të të drejtave të njeriut, qasjes së qytetarëve në drejtësi si dhe respektimit të afateve ligjore dhe procedurale.

Vonesat dhe shtyrja e seancave gjyqësore si dhe ndërprerja e tyre për shkaqe të ndryshme kishin ndikuar në zvarritjen e seancave gjyqësore si dhe në grumbullimin e lëndëve në gjykata.

Shkelja e afateve procedurale dhe mosrespektimi i tyre ndër faza të procedimit (nga momenti i pranimi të rasti në gjykatë, caktimi dhe mbajtja e shqyrtimit fillestar, dytësor dhe atij kryesor, si dhe përfundimi dhe shpallja e aktgjykimit), vazhdon të ketë pasoja në tejzgjatjen e shqyrtimeve gjyqësore dhe grumbullimin e vazhdueshëm të lëndëve, që gjithashtu konsiderohet shkelje e parimeve të drejtësisë për një gjykim të drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme.

Organizata Çohu! e konsideron praktikë të mbrapshtë trendin e parashkrimit të lëndëve penale që është rritur nga viti në vit. Duke u bazuar në të dhënat e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në periudhën nga viti 2000–2017 në gjykatat e Kosovës janë vjetërsuar 20.548 mijë lëndë penale. Në mesin e lëndëve të cilat janë parashkruar apo vjetërsuar, ka lëndë të natyrës korruptive, lëndë këto të cilat organet përkatëse e kanë pasur për detyrë t'i trajtojnë me prioritet. Vetëm gjatë viteve 2013–2018 në gjykatat e Republikës së Kosovës janë parashkruar 58 lëndë të kësaj natyre, prej tyre 8 në aspektin relativ ndërsa 50 prej tyre në aspektin absolut.

Gjatë monitorimit të gjykatave, Organizata Çohu! për periudhën 1 tetor 2018 – 30 shtator 2019, ka hasur në 10 raste të parashkrimit të lëndëve të natyrës korruptive në gjykatat themelore në Prishtinë, Pejë, Gjiilan, Gjakovë dhe Prizren.

Organizata Çohu! e konsideron po ashtu shqetësues numrin e vogël të rasteve të shqyrtuara të korrupsionit të të profilit të lartë si dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre. Dënimet e ulëta, hedhja poshtë e aktakuzave dhe lirimi i zyrtarëve të profilit të lartë dëshmon edhe njëherë për shkallën e ulët të luftimit dhe ndëshkimit të korrupsionit të nivelit të lartë.

Gjykatat vazhdojnë të kenë numër të madh të rasteve të bartura (trashëguara) ndër vite. Bartja e rasteve nga viti në vit po shkakton tejzgjatje të proceseve gjyqësore, e si pasojë e tejzgjatjeve të gjykimeve me vite kemi shkelje të drejtave të njeriut, shkelje flagrante të Kodit të Procedurës Penale në të cilin shprehimisht janë të cekura afatet brenda të cilës duhet të përfundojë një gjykim dhe në fund shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

REKOMANDIME

Të ndërmerren masa ndaj prokurorëve të cilat janë të përgatitur për seanca gjyqësore;

Të rishikohet procesi i vlerësimit të prokurorëve dhe gjykatësve, që të ndërmerren masa llogaridhënese ndaj gjykatësve apo prokurorëve të cilët shkaktojnë zvarritje të procesit gjyqësor;

Të rritet numri i bashkëpunëtorëve profesionalë nëpër prokurori dhe gjykata;

Të bëhet profilizimi i prokurorëve dhe gjykatësve për veprat penale si: krimi i organizuar, korrupsioni, krimet ekonomike, terrorizmi dhe të tjerë;

Të respektohet legjislacioni vendor dhe ai ndërkombëtar që lidhet me procedimin dhe përfundimin e rasteve brenda afateve ligjore, respektimin e të drejtës për qasje në drejtësi si dhe parimin e gjyqimit të drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme;

Të zgjidhen me prioritet rastet e vjetra të korrupsionit që të parandalohet parashkrimi i tyre;

Të ndërmerren masa ndaj gjykatësve për arsye të të cilëve shkaktohen vonesat dhe shtyrjet e shqyrtimit gjyqësor;

Të ndërmerren masa ndaj prokurorëve për arsye të të cilëve shkaktohen vonesat dhe shtyrjet e shqyrtimit gjyqësor;

Të evidentohen problemet dhe shkaqeve teknike të cilat shkaktojnë vonesën e fillimit të shqyrtimit gjyqësor, mosmbajtjen dhe shtyrjen e tyre;

Të rritet numri i gjykatësve në Gjykatën Themelore të Prishtinës;

Të rritet numri i përkthyesve profesionalë shqip-serbisht dhe anasjelltas në GjTh në Mitrovicë;

Të adresohen problemet në Mekanizmin Përcjellës për Veprat Penale Karakteristike të Këshillit Prokurorial të Kosovës, i cili vazhdon të ketë probleme me mospërputhjen e të dhënave sipas veprave karakteristike penale.

ANEKS

5. Efikasiteti i prokurorive dhe gjykatave në trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar

5.1 Rastet e korrupsionit ndër vite

Organizata Çohu! përveç monitorimit të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar në gjykatat themelore të Republikës së Kosovës, ka analizuar dhe ka krahasuar procedimin e lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar në prokuroritë dhe gjykatat themelore. Këto të dhëna përfshijnë lëndët e bartura (trashëguara), lëndët e pranuar, ato të zgjidhura, dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre si dhe lëndëve të mbetura në fund të vitit (të pazgjidhura) në gjykata dhe prokurori.

Duke u bazuar në të dhënat e KPK-së dhe KGJK-së, si gjykatat ashtu edhe prokuroritë prijnë me numër të madh të rasteve të korrupsionit. Në Tabelën 5 janë të pasqyruara të gjitha veprat penale të korrupsionit në prokurori për vitet 2015–2018, ndërsa në Tabelën 6 janë të pasqyruara të gjitha veprat penale të korrupsionit në gjykata për vitet 2015–2018.

Gjatë analizimit dhe krahasimit të të dhënave në periudhën 2015–2018 në rastet e korrupsionit në prokuroritë e Republikës së Kosovës është vërejtur mospërputhje e rasteve në periudhat kohore ndërmjet vitit 2017 dhe 2018. Konkretisht, të dhënat të cilat kanë figuruar më 31 dhjetor 2017 e të cilat do të duhej të ishin po ato të cilat trashëgohen në vitin vijues, përkatësisht më 1 janar

2018, nuk përputhen. Në Tabelën 5 paraqiten numrat e rasteve të pazgjidhura në prokuroritë themelore. Në fund të vitit 2017 figurojnë se janë 627 raste me 1642 persona ndërsa në kategorinë e rasteve të trashëguara në vitin 2018 figurojnë se janë vetëm 282 raste me 707 persona. Duke u bazuar në monitorimin e organizatës Çohu!, nuk është identifikuar efikasiteti i theksuar në trajtim të rasteve të korrupsionit nga prokuroritë e Republikës së Kosovës. Po ashtu, një mospërputhje e tillë e të dhënave në rastet e korrupsionit tregon për problemet e vazhdueshme në sistemin e drejtësisë sa i përket njësimit dhe procedimit të saktë të lëndëve të korrupsionit. Megjithatë, duke krahasuar të dhënat statistikore të KPK-së të pasqyruara në Tabelën 5 tek rastet në punë dhe rastet e proceduara nga viti në vit, vërehet trend pozitiv sa i përket numrit të rasteve të zgjidhura.

Krahas trendit pozitiv në procedimin e rasteve të korrupsionit i cili vërehet nga viti në vit, prokuroritë e Republikës së Kosovës vazhdojnë të kenë mungesë efikasiteti në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

		Të trashëguara		Të pranuar		Gjithsej në punë		Të proceduara (zgjidhura)		Të pazgjidhura	
Viti		KP	P	KP	P	KP	P	KP	P	KP	P
1	2015	539	1642	272	840	811	2482	456	921	539	1641
2	2016	541	1667	443	824	984	2491	661	1115	447	1208
3	2017	458	1323	619	1038	1077	2361	708	1486	627	1642
4	2018	282	707	385	890	696	1220	408	772	280	668

TABELA 5 Rastet e korrupsionit në Prokuroritë e Republikës së Kosovës ndër vite

Gjatë analizimit dhe krahasimit të të dhënave të gjykatave për rastet e korrupsionit, Organizata Çohu! ka vërejtur një trend të ngjashëm të lëndëve të bartura (trashëguara) ndër vite, të atyre të pranuar si dhe të rasteve të procedura (zgjidhura). Përderisa në vitin 2017 gjykatat kanë trashëguar një numër të konsiderueshëm të rasteve të korrupsionit, saktësisht 558 raste ndërsa janë pranuar 272 raste, në vitin 2018 janë bartur nga viti paraprak 541 raste ndërsa janë pranuar 233 raste. Raste të zgjidhura në gjykatat për vitin 2017 në total kanë qenë 289 ndërsa në vitin 2018 gjykatat kanë zgjidhur 255 raste të korrupsionit. Njëjtë si prokuroritë, gjykatat gjithashtu kanë vazhduar të kenë numër të konsiderueshëm të rasteve të pazgjidhura. Në Tabelën 6 janë të paraqitura të dhënat e rasteve të korrupsionit për periudhën 2015-2018, në të cilën vërehen se dënimet të cilat shqiptohen më së shumti janë dënimet me kusht, pastaj dënimet me gjobë, ndërsa dënimet me burgim shqiptohen më rrallë. Po ashtu, duke krahasuar të dhënat e KGJK-së nga viti në vit vërehet se përkundër prioritetit që do duhej të kishin rastet e korrupsionit sistemi i drejtësisë vazhdon të ketë mungesë të efikasitetit të zgjidhjes së këtyre lëndëve.

Numri i rasteve të proceduaranë gjykata themelore, sipas viteve

Viti	Të bartura	Të pranuar	Gjithsej në punë	Të zgjidhura							Gjithsej të zgjidhura	Të mbetura
				Burg	Gjobë	Kusht	Tjera	Aktgjykime	Parashkrim	Tjera		
2015	662	282	944	34	40	53	1	33	13	55	229	671
2016	671	258	929	54	40	67	2	133	20	42	358	571
2017	558	272	572	33	58	70	0	70	14	44	289	539
2018	541	233	774	23	46	57	1	85	10	33	255	518

TABELA 6 Rastet e korrupsionit në Gjykatat Themelore ndër vite

5.2 Rastet e krimit të organizuar ndër vite

Organizata Çohu! gjatë analizimit dhe krahasimit të të dhënave për periudhën 2015-2018 të rastet e krimit të organizuar në Prokuroritë e Republikës së Kosovës ka vërejtur trend pothuajse të njëjtë të procedimit të lëndëve nga viti në vit, përderisa në vitin 2017 kanë qenë të bartura (trashëguara) 42 raste, në vitin 2018 figuron përsëri i njëjti numër i rasteve të trashëguara nga viti paraprak. Në vitin 2017 të pranuar ishin 5 raste me 33 persona në të gjitha prokuroritë ndërsa në vitin 2018 të pranuar ishin 6 raste me 34 persona. Të proceduara (zgjidhura) në vitin 2017 në prokurori janë 4 raste me 59 persona, ndërsa në vitin 2018 janë 13 raste me 70 persona.

Në Tabelën 7 është pasqyruar mënyra e procedimit të rasteve të krimit të organizuar për vitet 2015, 2016, 2017 dhe 2018, në të cilat vërehet se vetëm një numër i vogël i rasteve është zgjidhur, ndërsa numri më i madh i rasteve në fund kanë mbetur të pazgjidhura.

Viti		Të trashëguara		Të pranuar		Gjithsej në punë		Të proceduara (zgjidhura)		Të pazgjidhura	
		KP	P	KP	P	KP	P	KP	P	KP	P
1	2015	41	311	14	156	146	467	16	113	47	354
2	2016	49	420	2	27	51	447	23	185	40	344
3	2017	42	355	5	33	47	388	4	59	42	321
4	2018	42	227	6	34	48	261	13	70	35	191

TABELA 7 Rastet e krimit të organizuar në Prokuroritë e Republikës së Kosovës ndër vite



Njëjtë si prokuroritë, gjykatat kanë vazhduar të kenë numër të konsiderueshëm të rasteve të pazgjidhura. Në Tabelën 7 janë të pasqyruara rastet e krimit të organizuar për vitet e njëjta (2015, 2016, 2017, 2018). Gjatë analizimit dhe krahasimit të procedimit të rasteve ndër vite vërehet mungesa e efikasitetit të gjykatave në zgjidhjen e rasteve të krimit të organizuar. Në vitin 2017 nga 62 raste gjithsej në punë, janë të zgjidhura gjithsej 5 raste, 57 raste janë të pazgjidhura ndërsa në vitin 2018 nga 68 raste në punë, 6 raste ishin të zgjidhura kurse 62 raste kishin mbetur të pazgjidhura.

Numri i rasteve të proceduaranë gjykata themelore, sipas viteve

Viti	Të bartura	Të pranuar	Gjithsej në punë	Të zgjidhura							Gjithsej të zgjidhura	Të mbetura
				Burg	Gjobë	Kusht	Tjera	Aktgjykime	Parashkrim	Tjera		
2015	35	13	48	1	0	0	0	0	0	1	2	46
2016	46	15	61	3	0	0	0	0	0	0	3	59
2017	57	5	62	3	1	0	0	0	0	1	5	57
2018	57	11	68	4	0	0	0	0	0	2	6	62

TABELA 8 Rastet e krimit të organizuar në Gjykatat Themelore, ndër vite

Bazuar në gjetjet dhe të dhënat sipas viteve, gjykatat vazhdojnë të jenë joefikase në trajtimin e rasteve të Krimit të Organizuar. Vetëm një numër i vogël të rasteve të krimit të organizuar vazhdon të procedohet e të zgjidhet tutje, derisa numri i konsiderueshëm i tyre mbeten të pazgjidhura dhe barten nga viti në vit. Një dukuri e tillë e bartjes së lëndëve nga viti në vit vazhdon të shkaktojë zvarritje të konsiderueshme të procedurave gjyqësore e cila pasqyron mungesë të efikasitetit të gjykatave dhe shkelje të të drejtave për gjykim të drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme.

5.3 Rastet e seancave që kanë filluar me vonesë

Bazuar në të dhënat e monitorimit të cilat edhe janë paraqitur në formë tabelore në pjesën e fundit të këtij punimi (Aneks), janë identifikuar 97 raste të fillimit me vonesë të seancave gjyqësore, 43 raste të vonesave për shkak të trupit gjykues, 25 raste prokurori, në 3 raste avokati, në 13 raste i akuzuar, 3 raste i dëmtuari si dhe në 7 raste shkaqe të tjera.

	Gjykata	Nr. i lëndës	Data	Koha	Arsyeja e vonesës
1	GjTh në Prishtinë	PKR.510/14	18 tetor 2018	Vonesë	Trupi gjykues
2	GjTh në Pejë	PKR-5/18	19 dhjetor 2018	Vonesë	Trupi gjykues
3	GjTh në Prizren	PKR-211/16	19 nëntor 2018	Vonesë	Trupi gjykues
4	GjTh në Ferizaj	PKR.nr.192/17	9 tetor 2018	Vonesë	Trupi gjykues
5	Prishtinë	PKR.nr.618/13	20 janar 2019	Vonesë	Trupi gjykues
6	Prishtinë	PKR.nr.53/17	22 tetor 2018	Vonesë	Trupi gjykues
7	Prishtinë	PKR.nr.476/15	12 nëntor 2018	Vonesë	Trupi gjykues

8	Prishtinë	PKR.nr.111/17	6 mars 2019	Vonesë	Trupi gjykues
9	Prishtinë	PKR.253/17	17 dhjetor 2018	Vonesë	Trupi gjykues
10	Prishtinë	PKR.nr.51/14	26 dhjetor 2018	Vonesë	Trupi gjykues
11	Prishtinë	PKR.227/17	30 janar 2019	Vonesë	Trupi gjykues
12	Prishtinë	PKR.nr.276/16	27 shkurt 2019	Vonesë	Trupi gjykues
13	Prishtinë	PKR.198/17	11 shkurt 2019	Vonesë	Trupi gjykues
14	Prishtinë	PKR.nr.164/17	3 prill 2019	Vonesë	Trupi gjykues
15	Prishtinë	PKR.nr.519-13	2 korrik 2019	Vonesë	Trupi gjykues
16	Prishtinë	PKR.nr. 40-18	7 qershor 2019	Vonesë	Trupi gjykues
17	Prishtinë	PKR.nr.305-16	14 qershor 2019	Vonesë	Trupi gjykues
18	Prishtinë	PKR.nr.458-16	30 prill 2019	Vonesë	Trupi gjykues
19	Prishtinë	PKR.nr.314-16	21 shkurt 2019	Vonesë	Trupi gjykues
20	Prishtinë	PKR.nr.371-17	3 prill 2019	Vonesë	Trupi gjykues
21	Prishtinë	PKR.nr. 886/13	06 maj 19	Vonesë	Trupi gjykues
22	Prishtinë	Pkr.nr. 712/14	06 shkurt 2019	Vonesë	Trupi gjykues
23	Prishtinë	Pkr.nr. 712/14	1 prill 19	Vonesë	Trupi gjykues
24	Prishtinë	PKR.nr.113/17	04 dhjetor 2018	Vonesë	Trupi gjykues
25	Prishtinë	PKR.nr.476-15	12 nentor 2018	Vonesë	Trupi gjykues
26	Pejë	PKR.nr. 5/18	1 mars 2019	Vonesë	Trupi gjykues
27	Ferizaj	P.nr.173/17	10 dhjetor 2018	Vonesë	Trupi gjykues
28	Ferizaj	P.nr.173/17	17 janar 19	Vonesë	Trupi gjykues
29	Ferizaj	P.nr.173/17	18 janar 19	Vonesë	Trupi gjykues
30	Ferizaj	PKR.57/15	15 tetor 2019	Vonesë	Trupi gjykues
31	Ferizaj	PKR.nr.204/17	11 dhjetor 2018	Vonesë	Trupi gjykues
32	Ferizaj	PKR.nr.204/17	5 mars 2019	Vonesë	Trupi gjykues
33	Ferizaj	PKR.nr.204/17	1 prill 19	Vonesë	Trupi gjykues
34	Ferizaj	PKR.37/17	14 dhjetor 2018	Vonesë	Trupi gjykues
35	Ferizaj	PKR.37/17	31 janar 2019	Vonesë	Trupi gjykues
36	Mitrovicë	P.nr. 101/17	13 nëntor 2018	Vonesë	Trupi gjykues
37	Mitrovicë	Pkr.nr. 117/19	17 janar 19	Vonesë	Trupi gjykues



38	Mitrovicë	P.nr. 147/17	30 tetor 2018	Vonesë	Trupi gjykues
39	Mitrovicë	P.nr. 147/17	7 maj 2019	Vonesë	Trupi gjykues
40	Prishtinë	PKR.204/18	22 gusht 2019	Vonesë	Trupi gjykues
41	Prishtinë	PKR.nr. 305/16	14qershor 2019	Vonesë	Trupi gjykues
42	Prishtinë	PKR.nr.519/13	2 korrik 2019	Vonesë	Trupi gjykues
43	Prishtinë	PKR.nr.40/18	7 qershor 2019	Vonesë	Trupi gjykues
44	Prishtinë	PKR.332/17	24 dhjetor 2018	Vonesë	Prokurori
45	Prishtinë	PKR.nr.356/17	30 janar 2019	Vonesë	Prokurori
46	Prishtinë	PKR.nr.627/15	15 prill 19	Vonesë	Prokurori
47	Prishtinë	PKR.nr.627/15	24 maj 19	Vonesë	Prokurori
48	Prishtinë	Pkr.nr. 253/17	17 dhjetor 2018	Vonesë	Prokurori
49	Prishtinë	PKR.nr.110-17	9 nëntor 2018	Vonesë	Prokurori
50	Prishtinë	PKR.nr.369-16	22 nëntor 2018	Vonesë	Prokurori
51	Prishtinë	PKR.nr.18/15	23 prill 2019	Vonesë	Prokurori
52	Mitrovicë	P.nr. 67/15	21 mars 19	Vonesë	Prokurori
53	Mitrovicë	P.nr. 210/15	6 nëntor 2018	Vonesë	Prokurori
54	Prizren	PKR-79/18	29 nëntor 2018	Vonesë	Prokurori
55	Prizren	PKR-79/18	15 shkurt 2019	Vonesë	Prokurori
56	Ferizaj	PKR.57/15	15 nëntor 2018	Vonesë	Prokurori
57	Ferizaj	PKR.57/15	19 nëntor 2018	Vonesë	Prokurori
58	Ferizaj	PKR.57/15	20 nëntor 2018	Vonesë	Prokurori
59	Ferizaj	PKR.57/15	27 nëntor 2018	Vonesë	Prokurori
60	Ferizaj	PKR-9/18	24 tetor 2018	Vonesë	Prokurori
61	Ferizaj	PKR.37/17	18 mars 2019	Vonesë	Prokurori
62	Ferizaj	PKR.37-17	25 prill 2019	Vonesë	Prokurori
63	Ferizaj	PKR.244/18	17 prill 2019	Vonesë	Prokurori
64	Ferizaj	PKR.244/18	18 prill 2019	Vonesë	Prokurori
65	Gjakovë	PKR-36/18	8 tetor 2018	Vonesë	Prokurori
66	Gjakovë	PKR-36/18	19 tetor 2018	Vonesë	Prokurori
67	Gjakovë	PKR-50/18	17 tetor 2018	Vonesë	Prokurori

68	Gjakovë	PKR-50/18	19 tetor 2018	Vonesë	Prokurori
69	Mitrovicë	P.nr. 129/17	14 janar 2019	Vonesë	Avokati
70	Mitrovicë	P.nr. 129/17	20 nëntor 2018	Vonesë	Avokati
71	Mitrovicë	P.nr. 135/18	7 qershor 2019	Vonesë	Avokati
72	Prizren	PKR.nr. 17/18	12 mars 2019	Vonesë	Avokati
73	Ferizaj	P.nr. 173/17	21 shkurt 2019	Vonesë	Avokati
74	Prishtinë	PKR.142/18	30 korrik 2019	Vonesë	Akuzuari
75	Mitrovicë	P.nr. 129/17	1 mars 2019	Vonesë	Akuzuari
76	Prishtinë	PKR.nr. 439/15	14 nëntor 2018	Vonesë	Akuzuari
77	Prishtinë	PKR.nr.610/15	16 nëntor 2018	Vonesë	Akuzuari
78	Prishtinë	PKR.nr. 18/15	11 mars 2019	Vonesë	Akuzuari
79	Pejë	PKR.nr. 5/19	12 shkurt 2019	Vonesë	Akuzuari
80	Pejë	PKR.nr. 111/18	31 janar 2019	Vonesë	Akuzuari
81	Ferizaj	P.nr. 173/17	12 tetor 2018	Vonesë	Akuzuari
82	Gjakovë	PKR.nr. 36/18	18 dhjetor 2018	Vonesë	Akuzuari
83	Gjakovë	PKR.nr. 36/18	11 shkurt 2019	Vonesë	Akuzuari
84	Gjakovë	PKR.nr. 36/18	15 shkurt 2019	Vonesë	Akuzuari
85	Gjakovë	PKR.nr. 36/18	19 shkurt 2019	Vonesë	Akuzuari
86	Gjakovë	PKR.nr. 5/19	25 qershor 2019	Vonesë	Akuzuari
87	Pejë	PKR.nr. 26/18	13 prill 2019	Vonesë	Dëshmitari
88	Prishtinë	PKR.nr. 519/13	22 nëntor 2018	Vonesë	Dëmtuari
89	Prishtinë	PKR.nr. 519/13	28 dhjetor 2018	Vonesë	Dëmtuari
90	Ferizaj	PKR.nr. 204/17	21 dhjetor 2018	Vonesë	Dëmtuari
91	Prishtinë	PKR.nr. 618/13	19 tetor 2018	Vonesë	Shkaqe të tjera
92	Prishtinë	PKR.nr.734/15	17 nëntor 2018	Vonesë	Shkaqe të tjera
93	Prishtinë	PKR.nr. 610/16	25 qershor2019	Vonesë	Shkaqe të tjera
94	Prishtinë	PKR.nr. 199/17	12 nëntor 2018	Vonesë	Shkaqe të tjera
95	Prishtinë	PKR.nr. 242/18	24 maj 19	Vonesë	Shkaqe të tjera
96	Mitrovicë	PKR.nr. 156/17	29 janar 2019	Vonesë	Shkaqe të tjera
97	Ferizaj	PKR.nr. 204/17	6 nëntor 2018	Vonesë	Shkaqe të tjera

TABELA 9 Rastet e fillimit me vonesë të seancave gjyqësore.



5.4 Rastet e shtyrjes së seancave gjyqësore

Në Tabelën 10 janë të paraqitura rastet e shtyrjes së seancave gjyqësore. Gjatë periudhës njëvjeçare të monitorimit Organizata Çohu! ka identifikuar 114 raste të shtyrjes së seancave gjyqësore në shtatë gjykatat themelore në Kosovë. Nga 114 raste të shtyrjes së seancave gjyqësore 30 prej tyre ishin shtyrë për shkak të prokurorit, 14 për shkak të trupit gjykues, 34 për shkak të të akuzuarit, 17 për shkak të të akuzuarit, 4 për shkak të dëshmitarit, 6 për shkak të të dëmtuarit, 1 për shkak të ekspertit dhe 9 seanca janë shtyrë për shkaqe të tjera.

	Gjykata	Nr. i lëndës	Data	Arsyeja e shtyrjes
1	Prishtinë	PKR.nr.734-15	12 dhjetor 2018	Prokurori
2	Prishtinë	PKR.nr.734-15	29 janar 2019	Trupi gjykues
3	Prishtinë	PKR.nr. 204-18	16 maj 2019	Akuzuari
4	Prishtinë	PKR.nr.371-17	10 maj 2019	Prokurori
5	Prishtinë	PKR.nr. 371-17	31 maj 2019	Prokurori
6	Prishtinë	PKR.nr. 230-18	28 janar 2019	Akuzuari
7	Prishtinë	PKR.nr. 230-18	14 mars 2019	Akuzuari
8	Prishtinë	PKR.nr.305/16	29 janar 2019	Akuzuari
9	Prishtinë	PKR.nr. 305/16	14 qershor 2019	Akuzuari
10	Prishtinë	PKR.nr.476-15	30 tetor 2018	Dëmtuari
11	Prishtinë	PKR.nr. 40-18	21 dhjetor 2018	Akuzuari
12	Prishtinë	PKR.nr.96-18	21 maj 2019	Prokurori
13	Prishtinë	PKR.nr. 110-17	09 nëntor 2018	Prokurori
14	Prishtinë	PKR.nr.132-19	18 qershor 2019	Prokurori
15	Prishtinë	PKR.nr. 148-17	23 nëntor 2018	Prokurori
16	Prishtinë	PKR.nr.148-18	21 mars 2019	Prokurori
17	Prishtinë	PKR.nr.205-18	14 mars 2019	Avokati
18	Prishtinë	PKR.nr. 253-17	22 shkurt 2019	Prokurori
19	Prishtinë	PKR.nr.327-17	6 dhjetor 2018	Akuzuari
20	Prishtinë	PKR.nr.355-17	24 qershor 2019	Prokurori
21	Prishtinë	PKR.nr.610-16	16 nëntor 2018	Avokati
22	Prishtinë	PKR.nr.610-16	12 mars 2019	Akuzuari
23	Prishtinë	PKR.nr.610-16	16 maj 2019	Akuzuari
24	Prishtinë	PKR.nr.18-15	14 dhjetor 2018	Akuzuari

25	Prishtinë	PKR.nr.18-15	9 janar 2019	Avokati
26	Prishtinë	PKR.nr.145-17	13 shkurt 2019	Trupi gjykues
27	Gjakovë	PKR.nr.36/18	8 tetor 2018	Akuzuari
28	Gjakovë	PKR.nr.50/18	17 tetor 2018	Avokati
29	Gjakovë	PKR.nr.106/17	9 nëntor 2018	Prokurori
31	Gjakovë	PKR.nr.25/18	5 nëntor 2018	Trupi gjykues
32	Gjakovë	PKR.nr.44/16	7 nëntor 2018	Prokurori
33	Gjakovë	PKR.nr.50/18	26 nëntor 2018	Shkaqe të tjera
34	Gjakovë	PKR.nr.17/18	4 dhjetor 2018	Dëshmitar
35	Gjakovë	PKR.nr.36/18	18 dhjetor 2018	Akuzuari
36	Prizren	PKR.nr.79/18	24 janar 2019	Avokati
37	Prizren	PKR.nr.99/18	29 janar 2019	Demtuari
38	Prizren	PKR.nr.132/14	30 janar 2019	Akuzuari
39	Gjakovë	PKR.nr.50/18	6 shkurt 2019	Avokati
40	Prizren	PKR.nr.44/16	8 shkurt 2019	Avokati
41	Pejë	PKR.nr.106/17	14 shkurt 2019	Avokati
42	Gjakovë	PKR.nr.5/19	25 shkurt 2019	Akuzuari
43	Pejë	PKR.nr.47/18	28 shkurt 2019	Prokurori
44	Prizren	PKR.nr.119/18	7 mars 2019	Trupi gjykues
45	Prizren	PKR.nr.13/19	21 mars 2019	Akuzuari
46	Gjakovë	PKR.nr.58/18	10 prill 2019	Akuzuari
47	Prizren	PKR.nr.19/19	15 prill 2019	Akuzuari
48	Gjakovë	PKR.nr.14/19	18 prill 2019	Avokati
49	Gjakovë	PKR.nr.5/19	25 prill 2019	Akuzuari
50	Gjakovë	PKR.nr.14/19	26 prill 2019	Demtuari
51	Pejë	PKR.nr.26/18	23 maj 2019	Prokurori
52	Pejë	PKR.nr.26/18	11 qershor 2019	Trupi gjykues
53	Prizren	PKR.nr.26/19	5 qershor 2019	Akuzuari
54	Pejë	PKR.nr.227/16	17 qershor 2019	Prokurori
55	Prizren	PKR.nr.42/19	19 qershor 2019	Shkaqe të tjera



56	Pejë	PKR.nr.227/16	27 qershor 2019	Akuzuari
57	Mitrovicë	Pkr.nr. 37/19	17 prill 2019	Shkaqe të tjera
58	Mitrovicë	PKR.nr. 67/15	1 shkurt 2019	Akuzuari
59	Mitrovicë	P.nr. 46/16	10 nëntor 2019	Dëshmitar
60	Mitrovicë	P.nr. 147/17	30 tetor 2018	Akuzuari
62	Mitrovicë	P.nr. 141/18	5 shkurt 2019	Shkaqe të tjera
63	Mitrovicë	P.nr. 51/19	10 maj 19	Avokati
64	Mitrovicë	P.nr. 122/16	6 maj 19	Akuzuari
65	Mitrovicë	P.nr. 111/18	17 janar 2019	Prokurori
66	Mitrovicë	P.nr. 210/15	5 shkurt 2019	Akuzuari
67	Mitrovicë	P.nr. 210/15	6 nëntor 2018	Prokurori
68	Mitrovicë	P.nr. 135/18	5 prill 2019	Akuzuari
69	Mitrovicë	P.nr. 121/18	15 janar 2019	Dëmtuari
70	Mitrovicë	P.nr. 121/18	25 janar 2019	Dëshmitar
71	Mitrovicë	PKR.nr. 140/17	25 janar 2019	Avokati
72	Mitrovicë	PKR.nr. 156/17	29 janar 2019	Avokati
73	Prishtinë	PKR.nr.627/15	15 maj 2019	Prokurori
74	Prishtinë	PKR.nr.627/15	24 maj 2019	Prokurori
75	Prishtinë	Pkr. 199/17	12 nëntor 2018	Shkaqe të tjera
76	Prishtinë	Pkr.nr. 253/17	17 dhjetor 2018	Prokurori
77	Prishtinë	PKR.nr.242/18	24 maj 19	Shkaqe të tjera
78	Prishtinë	Pkr.nr. 712/14	1 prill 2019	Trupi gjykues
79	Prishtinë	PKR.nr.113/17	4 dhjetor 2018	Trupi gjykues
80	Prishtinë	PP/I nr.7/2014	23 tetor 2018	Shkaqe të tjera
81	Ferizaj	P.nr.173/17	13 nëntor 2018	Trupi gjykues
82	Prishtinë	PKR.nr.111/17	17 dhjetor 2018	Prokurori
83	Prishtinë	PKR-164/2017	17 dhjetor 2018	Prokurori
84	Ferizaj	PKR.193/17	12 mars 2019	Prokurori
85	Ferizaj	PKR.193/17	28 mars 2019	Prokurori
86	Prishtinë	PPS.nr.73/2013	6 shkurt 2019	Prokurori

87	Ferizaj	P.nr.173/17	21 shkurt 2019	Trupi gjykues
88	Prizren	PKR.nr.19/19	2 korrik 2019	Avokati
89	Gjakovë	PKR.nr.64/18	05 korrik 2019	Avokati
90	Gjakovë	PKR.nr.58/18	9 korrik 2019	Avokati
91	Gjakovë	PKR.nr.58/18	11 korrik 2019	Avokati
92	Prizren	PKR.nr.24/19	15 korrik 2019	Akuzuari
93	Pejë	PKR.nr. 26/18	17 qershor 2019	Prokurori
94	Gjakovë	PKR.nr. 14/19	2 korrik 2019	Akuzuari
95	Pejë	PKR.nr. 106/17	19 gusht 2019	Prokurori
96	Gjakovë	PKR.nr. 15/19	20 maj 2019	Dëmtuari
97	Prizren	PKR.nr. 87/18	29 gusht 2019	Trupi gjykues
98	Pejë	PKR.nr. 41/19	27 gusht 2019	Dëmtuari
99	Pejë	PKR.nr. 26/18	20 shtator 2019	Trupi gjykues
100	Prizren	PKR.nr. 42/19	3 shtator 2019	Trupi gjykues
101	Prizren	PKR.nr.42/19	19 shtator 2019	Prokurori
102	Prizren	PKR.nr. 24/19	3 shtator 2019	Trupi gjykues
103	Prishtinë	PKR.nr.142/18	30 korrik 2019	Akuzuari
104	Prishtinë	PKR.nr.206/18	10 korrik 2019	Trupi gjykues
105	Prishtinë	PKR.nr. 206/18	9 shtator 2019	Akuzuari
106	Prishtinë	PKR.nr. 439/16	17 shtator 2019	Shkaqe të tjera
107	Prishtinë	PKR.nr. 16/18	30 korrik 2019	Dëshmitari
108	Prishtinë	PKR.nr. 1/19	28 korrik 2019	Akuzuari
109	Prishtinë	PKR.nr. 40/18	19 shtator 2019	Trupi gjykues
110	Prishtinë	PKR.nr.96/18	19 gusht 2019	Eksperti
111	Prishtinë	PKR.nr. 185/18	18 shtator 2019	Akuzuari
112	Prishtinë	PKR.nr. 192/18	12 shtator 2019	Avokati
113	Prishtinë	PKR.nr. 325/18	5 shtator 2019	Shkaqe të tjera
114	Prishtinë	PKR.nr. 610/16	5 shtator 2019	Avokati
115	Prishtinë	PKR.nr. 760/16	15 korrik 2019	Dëshmitari

TABELA 10 Rastet e shtyrjes së seancave gjyqësore.



5.5 Rastet e ndërprerjes së seancave gjyqësore

Organizata Çohu! gjatë monitorimit ka identifikuar raste të mosrespektimit të dispozitave ligjore, konkretisht të dispozitës 312 të KPK-së e cila në paragrafin 3 parasheh respektimin e një afati 8-ditor të vazhdimit të seancave gjyqësore pas ndërprerjes së saj, e gjithashtu situatën dhe rastet kur shqyrtimi gjyqësor i ndërprerë mund ta tejkalojë këtë afat 8-ditor.

Në Tabelën 11 janë të paraqitura 30 rastet në të cilat nuk është respektuar dispozita 312 e KPK-së, në gjykatat e monitoruara për periudhën tetor 2018 – shtator 2019.

Ndërprerja e seancave gjyqësore (neni 312 I KPK-së)

Gjykata Numri i lëndës Data e monitorimit		
Prishtinë	PKR.nr.476/15	12 nëntor 2018
Prishtinë	PKR.nr. 439/15	24 dhjetor 2018
Prishtinë	PKR.nr. 3/18	5 mars 2019
Prishtinë	PKR.nr. 397/17	5 dhjetor 2018
Prishtinë	PKR.nr.149/17	16 prill 2019
Prishtinë	PKR.nr.269/16	19 shkurt 2019
Prishtinë	PKR.nr.458/16	20 shkurt 2019
Prishtinë	PKR.nr. 16/18	17 prill 2019
Pejë	PKR.nr.168/16	19 nëntor 2018
Pejë	PKR.nr. 5/18	19 dhjetor 2018
Pejë	PKR.nr. 106/17	17 janar 2019
Pejë	PKR.nr.106/17	20 shkurt 2019
Pejë	PKR.nr. 50/18	11 shkurt 2019
Pejë	PKR.nr. 5/18	1 mars 2019
Pejë	PKR.nr.168/16	4 mars 2019
Pejë	PKR.nr. 47/18	28 mars 2019
Pejë	PKR.nr. 26/18	11 prill 2019
Pejë	PKR.nr. 26/18	13 prill 2019
Prizren	PKR.nr. 87/18	23 prill 2019
Prizren	PKR.nr. 91/18	10 maj 2019
Prizren	PKR.nr. 119/18	17 maj 2019
Ferizaj	PKR.nr.37/17	14 dhjetor 2018

Ferizaj	PKR.nr.37/17	14 janar 2019
Ferizaj	PKR.nr. 204/17	6 maj 2019
Gjakovë	PKR.nr.36/18	23 janar 2019
Gjakovë	PKR.nr.56/18	6 maj 2019
Gjilan	PKR.nr.129/18	8 maj 2019
Prishtinë	PKR.nr. 204/18	10 qershor 2019
Prishtinë	PKR.nr. 204/18	9 korrik 2019
Prizren	PKR.nr. 42/19	19 qershor 2019

TABELA 11 Gjykatat themelore me rastet e ndërprerjes së seancave gjyqësore.





Organizata për
Demokraci, Antikorrupsion
dhe Dinjitet, Çohu!



Kingdom of the Netherlands